

Muhaxhirët e vërtetë

Mendja, vlera dhe kufijtë e saj

Hixhreti si një sfidë për historinë

Haxhi i pranuar dhe umreja

Lugina e shkatërrimit

Kevtheri dhe kurban

Bajrami

HIXHRETI



Editorial

Të nderuar lexues.

Në qendër të këtij numri të revistës sonë vumë ngjarjen e madhe të emigrimit të profetit tonë Muhammed (a.s.) nga Meka për në Medine, ngjarje e cila në historinë Islame është përjetsuar me fjalën hixhret. Për njohësit e gjuhës arabe është më se e qartë se fjala hixhret në gjuhën arabe është ekuivalentja e fjalës emigrim, shpërngulje në gjuhën tonë të bukur shqipe. Por do të ishte naive të mëtoje për ta përcaktuar një ndër ngjarjet më të mëdha të historisë së bekuar islame brenda limiteve të të folmes së thjeshtë.

Do të ishte vlera dhe rëndësia që gëzon kjo ditë e cila do ta shtynte halifin e madh dhe të drejtë të dytë në rradhën kronologjike, halife Umerin që atë ditë të nxehtë kur Muhammedi (a.s.) largohej nga Mekka ta caktonte si ditën e fillimit të vitit hixhri.

Sado që largohej nga Mekka, shtëpia e tij e vendlindjes, për të vetmen arsye se i thërriste njerëzit drejt të vërtetës dhe pasi kishte përjetuar çdo lloj akti çnjerëzor ndaj tij dhe anëtarëve të bashkësisë muslimane Profetit i lotonin sytë nga malli për vendlindjen e tij. Do të kalonin plot 10 vjet që Profeti (a.s.) të kthehej në Mekke, ku ai shpalli amnistinë e madhe ndaj të gjithë atyre që e kishin sulmuar dhe dhunuar për sa vjet me rradhë besimin Islam.

Do të dallonim në këtë numër shkrimin e Prof. I. Lytifi Çakanit (pedagog i Hadithit në Universitetin e Marmarasë) i cili ngjarjen e hixhretit është përpjekur ta rrokë në disa aspekte si në atë historik, hapësinor dhe shpirtëror. Një studim i ri dhe i mirëfilltë është edhe artikulli i Mr. Qani Nesimit me titull “Hixhreti si një sfidë për historinë”. Autori i mirënjohur tashmë për lexuesin shqiptar, në sajë të veprave të botuara në gjuhën shqipe, Osman Nuri Topbash në këtë numër ka trajtuar si në planin shpirtëror, po edhe aq praktik haxhin, që përbën një ndër pesë kushtet bazë të besimit Islam. Shpresojmë se mes atyre rreshtave lexuesit që kanë patur fatin të shkojnë dhe të kryejnë këtë obligim kaq të rëndësishëm të besimit dhe fesë tonë të evokojnë kujtimet përdëlluese, ndërsa ata që nuk kanë pasur rastin dhe mundësitë që ta kryejnë deri tani, të shkrihen në lutjet e singerta që brenda një kohë të shkurtër të jenë ndër vizitorët e sarajit të përshpirtshmërisë fetare.

Një vend të rëndësishëm i është kushtuar edhe trajtimit të çështjes rreth përhapjes së besimit Islam duke u mbështetur në të vërteta historike dhe llogjike të cilat vetëm kryeneçët do të mund ti refuzonin.

Nuk kanë munguar edhe artikujt e tjerë nga fushat e mendimit fetar Islam si dhe rubrikat e ndryshme me të cilat jemi përpjekur ti japim një larmi me vend revistës sonë.

Edhe sot kumbojnë kuptimplote për çdo anëtar të besimit Islam në çdo cep dhe skutë të botës fjalët e Profetit tonë Muhammedit (a.s.) drejtuar mikut të tij më të ngushtë, njërit nga figurat më fisnike të fesë Islame, Ebu Bekrit (r.a.):

- Mos u brengos. Allahu (sh. sh.) është me ne!

Në këtë numër do të lexoni:

Muhaxhirët e vërtetë

Hixhreti fillon në zemrën e njeriut, vijon me përpjekjen për të gjetur një hapësirë ku mund të jetohej islami si shpirtërisht, ashtu edhe materialisht e pastaj pason me përmirësimin e gjendjes shoqërore edhe më gjerë...

I. Lutfi Çakan

04



Hixhreti i Ikrimes

M. Nexhati Bursallë

06

08

13 vjet në Mekë

Ahmet Marashllë

Hixhreti si një sfidë për historinë

Koha në të cilën jetojmë është e mbushur me ndodhi, raste e fenomene që na i kanë lodhur sytë duke i parë, veshët duke i dëgjuar, mendjen duke i menduar, dhe në fund asgjë për njeriun...

Mr. Qani Nesimi

13



Mirage

Alban Kali

12

20

Ngatërresat fetare dhe luftrat e përgjakshme në historinë e fesë së krishterë

Salih Inxhi

Bajrami

Jeta e njeriut fillon në vetvete me vuajtje, ato të nënës. Dhe si përfundim ai përsëri është udhëtar, i një udhëtimit të përgjeshëm, ku sprovimi mbizotëron përherë. Nuk ka si të jetë ndryshe, nëse jetojmë në një botë ku dëshirat dhe zellet e papërmbajtshme, tërheqin vëmendjen e egos tonë. Prandaj...

Xhahit Zafir

17



Islami u përhap me dialog dhe dashuri

Murat Kaja

24

29

Krijuesi

Gentiana Rexha

Këshillat e Llukmanit drejtuar birit të vet

Naim Drijaj

36

38

Si ta respektojmë Kur'anin?

Sadik Dana

Kevtheri dhe Kurbani

Kevther, vjen nga fjala arabe kethret që në shqip do të thotë "bollëk" dhe "begati". Gjithashtu, kevther është edhe emri i burimit të premtuar Muhammedit (a.s.) ku ai do të takohet me ummetin e tij, i cili do të jetë më i madh në numër, ditën e gjykimit...

Prof. Hasan Kamil Jëllmaz

18



Mos e shiko të vogël, asnjë të mirë

Fehmi Çiçek

39

Abonimet:

Abonimi vjetor për Shqipërinë, 600 Lekë; për Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi, 4 €.

Për Evropën, 10 € ose vlerën e saj. Ndërsa për shtetet e tjera, çmimi vjetor, 15 \$.

Bank Swift Code: ASYATRIS

Të interesuarit, pasi të njoftojnë qendrën e revistës, pagesën mund ta bëjnë tek numrat e llogarisë (IBAN):

në \$:

TR910020800058007092040002

në € :

TR640020800058007092040003

në CHF :

TR370020800058007092040004

Viti: II Numri: 7

Janar - Shkurt - Mars 2007
Dhulhixhe - Muharrem - Sefer
1427 - 1428

Çmimi: 60 DEN / 1 Euro / 150 Lek





Boton
SH. E. A. VËSHTRIMI:
Sead MORINA

Marketing:
Sead MORINA

Redaktorë gjuhësor-letrar:

Ermira Alija
Brikena Smajli
Gentijana Dizdari
Diana Bilali

Janar-Shkurt-Mars 2007

- Gjuha e dashurisë dhe e mirësisë**
Evans Drishti **42**
- Personaliteti i thirrësit Islam**
Sadik Mehmeti **47**
- "Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin"**
Libër që dhuron emocion dhe ngjall nostalgji...
Muhammet Sytari **49**
- Ligjet e përgjithshme të jetës profesionale**
Dhurata Kazazi **52**
- Boja e shkrimit blözë**
Evans Drishti **57**
- Këtej kaloi një Papë dhe Pas "Kuintave" në Stamboll**
Ermal Nurja **59**
- Shëndeti & Familja**
Arjan Ymeraj **61**
- Teknologji**
Ali Bardhi **63**
- Haxhi i pranuar dhe umreja**

Familjes së madhe njerëzore që zë fill me Hz. Ademin dhe Havanë (a.s.) i është caktuar si vendadhurimi Qabja dhe rrethina e saj që gjenden në Mekke, në mënyrë që të jetojnë në klimën e prehjes dhe lumturisë fetare...
30 Osman Nuri TOPBASH
- Lugina e shkatërrimit**

Njeriu është krijuar i tillë, që të ketë dëshirë për pasuri. Madje, nganjëherë, pasuria është ajo çfarë ai kërkon më tepër se çdo gjë tjetër. Muhammedi (a.s.) ka thënë: "Zemra e të moshuarit mbetet e re në dëshirën për dy gjëra: pasuri dhe jetë."
40 Ilda Canja
- Mendja, vlera dhe kufijtë e saj**

Në kohët e sotme, shumë njerëz i shohin fenë dhe mendjen si dy pole të kundërta. Një pjesë e tyre e konsiderojnë mendjen si kriter të palëkundshëm, kurse një pjesë tjetër e vlerësojnë interpretimin tradicional fetar si burim të vetëm.
44 Artur Tagani
- Një ngjarje e dhimbshme emigrimi dhe Ummu Seleme**

Emri i vërtetë ishte Hind. Babai quhej Ebu Umejje dhe ishte nga fisi i Mahzunëve ndërsa e ëma quhej Atike bint Amir. Ummu Seleme ishte martuar me Abdullah bin Abdu'l-Esedin.
55 Fatma Kuru

Përkthyes:

Ermal Nurja
Ali Bardhi
Artur Tagani
Alban Kali
Elona Sytari
Elvira Puka
Arjan Ymeraj
Adem Pizga
Evans Drishti
Fatmir Sulaj
Zymer Ramadani

Dizenjo - Grafik:
Rasim SHAKIROV
rasimizm81@hotmail.com

Ngjyra: IBS Grafik
Tel: +90 216 530 29 44
Fax: +90 216 530 29 44

Shtyp: Shtëpia Botuese ERKAM
Tel: +90 212 671 07 00

Për artikuj:

web: www.revistaetika.com
e-mail: etika@revistaetika.com

editor@revistaetika.com - reklam@revistaetika.com

Adresa:

Dardania Rr. banesore 4/7-d-6
kati përdhës banesa Nr. 1 Prishtinë
Tel: +381 385 423 85

Adresa e përfaqësisë në Shqipëri:

Shoqata Vëllazërore Humanitare
Kulturore Stamboll
Bulevardi Zogu I pall. 97
ap. 21 shk. 2 Tiranë / Albania
Tel: +355 424 81 12

MUHAXHIRET E VERTETE



Abdullah b. Amër (r.a.) transmeton se Profeti (a.s.) ka thënë :

"... Muhaxhir (emigrues nga Mekka për në Medine) i vërtetë është ai që largohet nga ndalimet e Allahut."

Muhaxhirët

Mesazhi hyjnor i cili pati një ndikim shumë të madh historik, i titullon heronjtë e emigrimit, muhaxhirë dhe i paraqet ata si grupin më të përsosur të popullit mysliman.

Ata u përballuan të parët (e ndoshta edhe më ashpër) me vështirësitë që i shfaqeshin përhapjes së Islamit duke sakrifikuar çdo gjë, deri në vetëflim, për vlerat e larta shpirtërore të Islamit, prandaj merituan edhe gradat më të larta.

Edhe pse të besoje, do të thoshte të humbje gjithçka, përsëri ata besuan sinqerisht dhe për këtë besim pranuan të shkonin deri në Habeshistan (Etiopi), duke mos e ditur se ç'i

Hixhreti fillon në zemrën e njeriut, vijon me përpjekjen për të gjetur një hapësirë ku mund të jetohet islami si shpirtërisht, ashtu edhe materialisht e pastaj pason me përmirësimin e gjendjes shoqërore edhe më gjerë. Të gjitha udhëzimet apo edhe thirrjet islame kanë si objektivin e tyre kryesor hixhretin e braktisjes së ndalesa-ve, apo haramëve të Allahut (xh.sh.).

priste atje. Për këtë arsye muhaxhirët janë personalitete, dhe hixhreti (emigrimi nga Mekka për në Medine) është ngjarje e shënuar.

HIXHRETI

Myslmanët u ndërgjegjësuan se obligimi i dytë pas imanit ishte pikërisht hixhreti si mundësia e vetme për t'u larguar nga shirk (politeizmi) dhe mushrikët (politeistët), sepse hixhreti ishte shkuarja drejt Islamit, apo më të mirës së mundshme. Në emër të islamit të heqësh dorë nga çdo gjë, ta konsiderosh atë si çështjen themelore të jetës, do të thoshte hixhret, pra, të heqësh dorë nga çdo gjë joislame për Islam.

Kuptimi semantik i fjalës hixhret, por edhe kuptimi që nxirret nga zbatimi historik i tij, është braktisje, largim apo zhvendosje. Ato që do të braktiseshin e në të njëjtën kohë qëllimi i braktisjes ishte shumë i rëndësishëm. Për të qenë muhaxhir nuk mjaftonte braktisja e Mekes, apo arritja në Medine. Personi që emigroi për t'u martuar me Ummul Kajsin u quajt në përputhje me qëllimin e tij si "muhaxhiri i Ummul Kajsit". Kjo përveç se pasqyron qartazi se hixhreti nuk është thjeshtë

zhvendosja fizike nga një vend në një tjetër, por edhe se ai përftohet edhe nga pse-të e braktisjes së gjërave. Njeriut i takon vetëm ajo çfarë ai synon apo qëllimon.

Viti i 8-të sipas hixhrit eliminonte mundësinë e të qenurit muhaxhir në kuptimin historik, pasi në këtë vit u çlirua Mekka. Hixhreti tani mund të ishte një kornizë e xhihadit apo qëllimit të tij. Konceptit të hixhretit historik, pra të shpërnguljes nga Mekka për në Medine, i kishte ardhur fundi.

HIXHRETI SI XHIHADI I SHEKUJVE

Hixhreti historik shënon periudhën e ditëve të vështira e të mundimshme që Islami hasi në fillimet e ndërtimit të tij. Në atë kohë nuk kishte gjë më të rëndësishme se të shkëputesh nga mushrikët dhe shirk, të bëje hixhret e të bashkohesh me myslimanët. Kuptimi parësor që përshkonte themelet e hixhretit mund të kishte mbetur në planin e dytë për shkak të rëndësisë së ngjarjeve **sociologjike**. Hixhreti, si një udhëtim që buronte nga besimi ishte jo vetëm një çështje që shqetësonte myslimanët, por edhe mushrikët. Përjetoheshin ngjarje nga më të rëndat dhe të

frikshmet. El-Muhaxhir b. Kunfuz u kap duke bërë hixhretin, dhe u imponua të heqë dorë nga ai. Atij me t'iu dhënë mundësia, e bëri hixhretin fshehtas dhe iu bashkangjit bashkësisë myslimane. Pejgamberi, pasi e dëgjoji historinë e tij, tha se ky është muhaxhiri i vërtetë. Që atë ditë emri i vërtetë i Ibn Kunfuzit u harrua, ai u thirr vazhdimisht "el- Muhaxhir".

Mirëpo një mundësi e tillë hixhreti nuk iu dha çdo myslimani. Por, si do të përfitonin nga hixhreti edhe myslimanët e tjerë? Hadithi, sipas të cilit muhaxhiri i vërtetë është ai që braktis gjërat e ndaluara nga Zotit (xh.sh.), është një përgjigje e mirë e pyetjes së mësipërme. Nëpërmjet këtij hadithi mësojmë se hixhreti nuk realizohet vetëm në konceptin vend, por edhe kohë. Pra, hixhreti konceptualisht është universal dhe i flet me të njëjtën fuqi çdo myslimani, madje edhe atij të sotmit.

EDHE ENSARET KISHIN MUHAXHIRET E TYRE

Nuk duhet harruar se çdo largim nga shirku dhe çdo mëkat që e përfaqëson atë është një hixhret, dhe se çdo person që e realizon atë në çfarëdo kushtesh që të gjendet, është muhaxhir. Nesai transmeton se Ibn Mes'udi shprehimisht ka thënë: "Edhe nga Ensarët kishte muhaxhirë; Medineja duke qenë vend ku mbretëronte shirku, ato erdhën në Akabe dhe i dhanë bej'at (t'i japësh fjalën dikujt për diçka) Muhammedit (a.s.)." (Nesai, Bej'at 13)

Hadithi i mësipërm tregon se hixhreti fillon në zemrën e njeriut, vijon me përpjekjen për të gjetur një hapësirë ku mund të jetohet Islami si shpirtërisht, ashtu edhe materialisht e pastaj pason me

përmirësimin e gjendjes shoqërore edhe më gjerë. Të gjitha udhëzimet apo edhe thirrjet islame kanë si objektivin e tyre kryesor hixhretin e braktisjes së ndalesave, apo haramëve të Allahut (xh.sh.). Ashtu sikurse thotë profeti (a.s.) ata që jetojnë në përputhje me principet e Islamit, si në hixhretin e bërë për Allahun ashtu edhe në vendlindjen e tyre, Allahu do t'i falë. Kjo falje apo mëshirë lidhet me përkujdesin e veçantë ndaj vlerave të Islamit. Muhaxhirët kanë si tiparin e tyre

Profeti Muhammed (a.s.) thotë: "Adhurimi aty ku mbizotëron përçarja dhe armiqësia është për mua hixhret." Simbas këtij hadithi, përpjekja për t'u bërë rob i Zotit ka sevapet e hixhretit.

themelor pikërisht këtë. Gjithashtu profeti Muhammed (a.s.) thotë: "Adhurimi aty ku mbizotëron përçarja dhe armiqësia është për mua hixhret." Simbas këtij hadithi, përpjekja për t'u bërë rob i Zotit ka sevapet e hixhretit. Qëllimi i hixhretit është mbijetesja e Islamit. Përpjekja për të mbajtur gjallë robërinë ndaj Zotit, në të njëjtën kohë mundëson të jetuarit e Islamit.

BRAKTISJA E HARAMEVE

Mund të jetë pak i vështirë kuptimi i hixhretit si braktisja e haramëve parë në këndvështrimin e hixhretit të parë, pra, atij historik. Por, secili është i ndërgjegjshëm se në kohët e sotme të largohesh nga haramet është pothuajse më

e vështirë se të largohesh nga vendlindja, familja, të afërmit apo miqtë. A nuk janë muhaxhirë ata besimtarë që largohen nga këto ndalesa, shpesh edhe të institucionalizuara, që kanë zënë çdo rrugë të jetës?

Sa i ngjashëm është perceptimi shoqëror i sotëm ndaj besimtarëve që i druhen mëkatit, me perceptimin e mushrikëve ndaj muhaxhirëve?!

Prandaj hadithi që kemi përmendur më lart përmban një të vërtetë shumë të madhe. Ajo është: "Muhaxhiri i vërtetë është ai që mund të braktisë ndalesat e Allahut."

NUK DUATE IKI NGA KY VEND

Një mysliman nga Ballkani po ankohej për gjendjen e tij. Një mik nga Stambolli e ftoi duke i thënë: "Nëse je mërzhitur shumë atje, eja këtu në Stamboll"

Besimtari ballkanas iu përgjigj:

- Nëse vij në Stamboll, atëherë nën shembullin tim do të emigrojnë edhe shumë besimtarë. Këtu numri i muslimanëve do të zvogëlohej aq shumë, saqë përpiluesit e hartave në botë nuk do ta marrin në konsideratë aspak komunitetin mysliman të këtushëm ..."

Besimtarët, që kanë të tilla mendime, a nuk mund të quhen muhaxhirë në vendlindjen e tyre?

Si përfundim, mund të themi se hixhreti përftohet duke u përmirësuar nga dita në ditë, duke qëndruar sa të jetë e mundur larg haramëve dhe dyshimeve. Nuk duhet harruar se çdo vepër e mirë është një hap i hedhur përpara në rrugën e hixhretit...

Përktheu: **Alban Kali**

Hixhreti i Ikrimes

Nga bota e mllëfit, në botën e Islamit...



Allahu, mbreti i krijimit i dhuroi kësaj bote trima sypatrembur e mjerisht të verbër ndaj mrekullive...Ebu Xhehli i kishte falur sy, por zemër të verbër. Ndërsa sytë i shihnin mrekullitë e krijimit, zemra e tij qe ndëshkuar në skutat më të errëta të injorancës...andaj ishte një ndër armiqtë më të ashpër të profetit (a.s.) Edhe i biri Ikrime ishte rritur me një frymë të tillë armiqësie, duke tentuar gjithnjë të zbehë figurën e Pejgamberit (a.s.), simbolit të nderit dhe të mirësisë.

Ikrime endej në labirintet e errëta, duke luftuar përkrah të atit kundër ushtrisë së pejgamberit. Sahabe Rafi bin Muadhi bie shehid në luftën e Bedrit ndërsa në luftën e Uhudit, Ikrime merr jetën e tre sahabeve. Me të vërtetë shquhej në betejë, por fatkeqësisht shpata e tij ishte nën urdhërin e kufrit dhe luftonte gjithnjë për të marrë hakun e të atit...Megjithëse, nuk do të ishte e largët koha ku shpata e tij nuk do i bindej më si më parë...

Vallë cila do të ishte dita ku Ikrime do të rilindte në botën e Islamit...!? Me ndihmën e Allahut, Pejgamberi (a.s.) me ushtrinë e tij kishte çliruar Meken. Tashmë Ikrimes bota i ishte shndërruar në një makth pa shpëtim. Frika e vdekjes kishte kapluar gjithë qenien e tij...Duke mos e njohur mëshirën e Pejgamberit (a.s.) mendonte se ai do të hakmerrej dhe kërkonte vend për t'u fshehur, por e gjithë kjo botë i dukej shumë e vogël.

Me shpresën e shpëtimit arratiset nga Meka dhe si breg shpëtimi i paraqitet Jemeni. Pas gjurmëve të arratisjes së tij, e shoqja Ummu Hakim ishte

stolisur me dritën e besimit, duke siguruar lumturinë e përjetshme...

Menjëherë i drejtohet Pejgamberit (a.s.):

- O i dërguar i Allahut, Ikrime duke iu frikësuar hakmarrjes suaj u arratis për në Jemen. A mund t'i jepni atij siguri jete?

Pejgamberi i mëshirës (s.a.v) iu përgjigj me një buzëqeshje flladitëse:

- Ai është i siguruar!

Ummu Hakim shumë e gëzuar nga përgjigjja e profetit (a.s.) niset për të ndaluar Ikrimen dhe e mbërrin atë në bregdetin Tihame. Ndërkohë, ai kishte hipur në anije... Kapiteni i anijes i drejtohet Ikrimes duke i thënë:

- O i arratisur, mundohu të shpëtosh veten!

Ikrime i çuditur pyet:

- Çfarë të bëj?

- Dëshmo për njësinë e Allahut, thuaj se s'ka Zot tjetër përveç Tij! Ikrime i trishtuar,...dridhej si gjethja para furtunës:

- Ky ishte shkaku i arratisjes sime.

Ummu Hakim, e nisur nga

Meka për të arritur Ikrimen, i thërret e entuziazmuar:

- O Ikrime, të kam sjellë lajm nga i Dërguari i Allahut (xh.sh.)...Mendohu dhe mos e humb veten!

Ikrime u shtang...ndërsa e shoqja iu afrua duke thënë:

- O Ikrime, kërkova nga Pejgamberi (a.s.) siguri për jetën tënde.

Në syte e Ikrimes u ndez e u shua një shkëndijë:

- Ti?! Ti e bëre këtë?

- Po!

- E ai të dha siguri?

- Nuk ke pse të arratisesh duke jetuar me frikën e vdekjes. Me arratisje nuk mund t'i shpëtosh kthetrave të saj.

Ikrime i mbërthyer nga ethet e emocionit, ndjeu ngrohtësinë e rrezeve të para të besimit Islam, rreze që do i ndriçonin rrugën e suksesit. Kthimi i Ikrimes, ishte një fitore më tepër, një kënaqësi më tepër, një buzëqeshje më tepër në fytyrën e Pejgamberit (a.s.).

Me një shikim që edhe xhennetet do ta kishin zili Pejgamberi (a.s.) duke e përqaftuar i tha:

- Mirëse erdhe o kalorës muhaxhir!

Nga kjo mikpritje e Pejgamberit (a.s.) në zemrën e Ikrimes çelën trëndafila të bardhë paqeje...

Bujaria dhe mirësia e Pejgamberit (a.s.) e kishin çrrënjësuar armiqtësinë e Ikrimes ndaj tij... Tek ishin ulur në mesxhid, Ikrime me një shikim të pangopur ndaj fytyrës së bekuar të të dërguarit të Allahut (xh.sh) tha:

- O më i besuari i njerëzve! Gruaja më tha se jam i siguruar...

- Të vërtetën ka thënë, ti je i siguruar!

Ikrime kokulur pyet:

- O zemërbujar! Në çfarë më fton mua?

- Në dëshmimin se s'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe që unë jam i dërguari i Tij, në faljen e namazit dhe në dhënien e zekatit!

Zemra e zbutur e Ikrimes kishte përçafuar Islamin.

- Nuk ka dyshim që ti thërret në atë që është më e saktë, më e vlefshme, më e bukur... Beto hem në Krijuesin e botëve se edhe para shpalljes, në mesin tonë ti ishe më i drejti, më i miri... Nga merita jote, pema e mirësisë dha frytet e saj...

O njeriu në qenien e të cilit janë mbledhur gjithë virtytet më të larta, dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij. Pejgamberi i mëshirës, ngriti duart dhe bëri dua për Ikrimen, tashmë të ndriçuar me nurin e Islamit:

- O Allah, fali të gjitha të këqijat që më bëri Ikrime. Fale çdo hap që bëri duke tentuar të njollose madhësinë Tënde!

Ja! Madhështia e mëshirës së profetit, fitoi zemrën e një ndër armiqtë të përбетuar të Islamit... Nje përsosje që historia nuk e kishte njohur asnjëherë.

Ikrime me të marrë Kur'anin në dorë, e puti, e vuri në ballë dhe duke qarë me dënesë thoshte:

- Fjala e Krijuesit tim, fjala e Allahut tim!



Ikrime shquhej si një komandant i zoti, si një mysliman i devotshëm... Nuk ishte e mundur, të ishe në një ambient me Pejgamberin (a.s.) dhe të mos bëheshe një mysliman i mirë, i denjë, me një shpirt të pastër, mbushur me iman. Ikrime (r.a.) tregoi trimëri të rrallë në luftën e Jermukut. Në momentin më të acaruar të luftës zbriti nga kali dhe hyri në radhët e amikut duke goditur çdo qafir që i dilte

përpara. Komandanti i ushtrisë Halid bin Velid (r.a.) i tha:

- Mos vepro kështu Ikrime! Vdekja jote do të ishte një humbje e madhe për muslimanët.

Hz. Ikrime duke ndëshkuar ndërgjegjen për gjithë vitet e tij të shkuara tha:

- O Velid! Ti ke një të kaluar të bukur me Profetin (s.a.v) ndërsa unë me babanë tim njiheshim si armiqtë më të rrezikshëm të tij.

Duke u kthyer nga ushtria Islame thirri:

- Kush vjen pas meje duke dhënë fjalën se do të luftojë deri në vdekje? Katërqind kalorës e ushtarë brohoritën me zë kumbues:

- Ne të japim fjalën!

...Dhe filloi një sulm i furishëm. Luftëtarët muslimanë luftuan deri në vdekje.

Shumë të plagosur rëndë, luftuan derisa plagët i mposhtnin duke u dhënë titullin shehid. Ndër to edhe Hz. Ikrime kishte marrë plagë vdekjeprurëse. Komandanti i ushtrisë Halid bin Velid (r.a.) iu afrua Hz. Ikrimes dhe birit të tij Amrit (r.a.). Tek sa ata po jetonin çastet e fundit të jetës, ua mori kokat në prehër dhe nisi t'u fshinte gjakun mbi fytyra. Tek u jepte ujë, nuk i mbante dot lotët...kurse babë dhe bir ia dorëzuan Allahut shpirtat e pastër, duke shtegtuar në botën e përjetshme...

Hz. Ikrime (r.a.) po ndahej përjetësisht nga kjo botë, për të shijuar kënaqësinë që do t'i dhuronte Ahireti.

LIGJI I SHENJTE:

ISLAMI, ndër mijëra udhë; e vetmja rrugë që na nxit për të gjetur të vërtetën!

Përktheu: **Elvira PUKA**



BAJRAMI

Xhahit Zafir

Jeta e njeriut fillon në vetvete me vuajtje, ato të nënës. Dhe si përfundim ai përsëri është udhëtar, i një udhëtimit të përjetshëm, ku sprovimi mbizotëron përherë. Nuk ka si të jetë ndryshe, nëse jetojmë në një botë ku dëshirat dhe zellet e papërmbajtshme, tërheqin vëmendjen e egos tonë. Prandaj vetëm për atë të cilin arrin të kuptojë origjinën e tij të vërtetë, jeta në këtë botë nuk është tjetër vetëm se një sprovim i madh, ndërsa vdekja, është kënaqësia e vërtetë e takimit të robit me Krijuesin e tij.

Prirja e njeriut për të gabuar dhe si rezultat trishtimi e ka zanafillën që herët në krijimin e tij. Sepse edhe “stërgjyshi” ynë Ademi (a.s.), si rrjedhojë e dëshirës Hyjnore, kishte gabuar (duke ngrënë pemën e ndaluar). Si pasojë e kësaj të fundit u zbrit në këtë botë duke lënë pas vendbanimin e tij, në Xhennet dhe duke jetuar kësisoj trishtimin e parë.

Jeta e njeriut fillon në vetvete me vuajtje, ato të nënës. Dhe si përfundim ai përsëri është udhëtar, i një udhëtimit të përjetshëm, ku sprovimi mbizotëron përherë. Nuk ka si të jetë ndryshe, nëse jetojmë në një botë ku dëshirat dhe zellet e papërmbajtshme, tërheqin vëmendjen e egos tonë. Prandaj vetëm për atë të cilin arrin të kuptojë origjinën e tij të vërtetë, jeta në këtë botë nuk është tjetër vetëm se një sprovim i madh, ndërsa vdekja, është kënaqësia e vërtetë e takimit të robit me Krijuesin e tij.

Ato të cilat egoja e tij i quan arritje në këtë botë të rreme nuk i ngjajnë tjetër, veçse shtëpive dhe kalave prej rëre me ndërtimin e të cilave argëtohen aq shumë çiliminjtë pranë bregut të detit; shtëpi apo edhe kala, fati i jetëgjatësisë lidhet ngushtë me dallgën më të lehtë...

Qëllimi i krijimit të njeriut është të adhurojë

Krijuesin e tij, njohja me të si dhe kontrolli i vetvetes. Në jetën e kësaj bote, shumë gjëra qofshin këto individuale apo shoqërore ndikojnë për mirë, por fatkeqësisht edhe për keq. Sigurisht, bajramet janë ato, që ndikojnë tek njeriu për të zgjuar ndjenjën e butësisë, zemërgjerësisë, vëllazërimit e besnikërisë. Njerëzit në këto ditë jetojnë momente të veçanta gëzimi, jo vetëm në planin personal, por gjerësisht, edhe në atë shoqëror duke ndarë gëzimin bashkë dhe duke e jetuar më shumë se asnjëherë vëllazërimit mes besimtarëve.

Në këtë botë, ku njeriu përballet me vështirësi të ndryshme, bajrami është një ditë gëzimi për të gjithë robërit e dhuruar nga Krijuesi Fuqiplotë. Kjo ditë duhet të fillojë me përkujdesjen e veçantë të besimtarit për të bërë të lumtur jetimët, të përvuajturit, njërëzit e trishtuar dhe ato që janë të vetmuar. Në këtë aspekt mund të lexojmë sa më shumë Fatiha dhe të japim sadaka edhe për të afërmit tanë që kanë ndërruar jetë. Është interesant fakti, që paraardhësit tanë i kanë kushtuar kujdes të veçantë ndërtimit të varrezave brenda qytetit, në mënyrë që kalimtarët të kujtojnë përherë vdekjen. Transmetohet se është thënë nga i Dërguari i Allahut: “Unë ju kam lënë dy këshillues. Njëri flet, tjetri hesht. Ai që flet është Kur’ani, ndërsa ai që hesht vdekja”.

Le të mendojmë sesa afër mund t’i qëndrojmë dhe se a i kemi gëzuar sadopak jetimët, të vetmuarit apo të varfërit. Në këtë ditë mund të fitojmë bereqetin dhe mirësinë duke i ndihmuar ato dhe duke ndërjerë se zemra e besimtarëve rreh si një e vetme! Në këtë kuptim bajrami është një mundësi që nuk duhet humbur, mundësi e cila duhet të shërbejë në zbulimin moral të njeriut në veçanti dhe shoqërisë në përgjithësi. Fatlum janë ata të cilët dinë ta vlerësojnë siç duhet këtë mundësi...

Përktheu: ELONA SYTARI



Kevtheri dhe Kurbani

Prof. Dr. H. Kamil Jëllmaz

Kevther, vjen nga fjala arabe *kethret* që në shqip do të thotë “bollëk” dhe “begati”. Gjithashtu, kevther është edhe emri i burimit të premtuar Muhammedit (a.s.) ku ai do të takohet me ummetin e tij, i cili do të jetë më i madhi në numër, ditën e gjykimit.

Shkaku i zbritjes së kësaj sureje ka qenë thënia “ebter” e mushrikëve për Muhammedin (a.s.) pas vdekjes së djalit të tij të fundit, që e ka kuptimin “i farësosur” ose “i shuar”.

Ngaqë Muhammedit (a.s.) nuk i rronin djemtë, mushrikë si puna e As b. Vailit mendonin se nuk ka kush që ta çojë përpara mesazhin hyjnor dhe se emri i Muhammedit (a.s.) dhe ai i Kur’anit të madhëruar do të harroheshin. Por Allahu (xh.xh.) Krijuesi i Gjithësisë deshi që ai të vazhdojë, si mëshirë deri në ditën e fundit të kësaj bote (kijamet).

Zbritja e kësaj sureje që një ngushëllim për zemrën e Muhammedit (a.s.) dhe një forcim i besimtarëve myslimanë. Allahu në këtë sure urdhëron e thotë:

“Ne, vërtetë të dhamë ty shumë të mira. Andaj, ti falu dhe pre kurban për hir të Zotit tënd! E s’ka dyshim se ai që të urren ty është farësosur.”

Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Ata që i thanë Pejgamberit “ebter” u zhdukën, pra nuk patën trashëgimtarë. Ndërsa Islami, vazhdoi dhe do të vazhdojë deri në kijamet.

Në suren Kevther pasi tregohen të mirat që i janë dhënë Pejgamberit (a.s.) siç është kevtheri, jepet edhe urdhëri për të dhe ummetin e tij për faljen e namazit dhe prerjen e kurbanit.

Fjala “kurban” ka kuptimin “afirim”. Ndërsa në terminologjinë fetarë, “të therurit e bagëtive” për hir të Allahut (xh.xh.) për t’iu afruar sa më shumë Atij”. Në Kur’an thuhet: **“Tek Allahu nuk arrijnë**

Ngaqë Muhammedit (a.s.) nuk i rronin djemtë, mushrikë si puna e As b. Vailit mendonin se nuk ka kush që ta çojë përpara mesazhin hyjnor dhe se emri i Muhammedit (a.s.) dhe ai i Kur’anit të madhëruar do të harroheshin. Por Allahu (xh.xh.) Krijuesi i Gjithësisë deshi që ai të vazhdojë, si mëshirë deri në ditën e fundit të kësaj bote (kijamet).

as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj... (el-Haxh, 37)

Kurbani, më tepër se sa ai material në vetvete përmban një kuptim shpirtëror. Nëse shohim ndodhinë e bijëve të Ademit (a.s.) vërejmë që rrugëzgjdhja e mosmarrëveshjes së tyre që kurbanit. Siç dihet Ademit (a.s.) dhe Havvas, Allahu (xh.xh.) u ka dhënë fëmijë binjakë, një djalë dhe një vajzë. Sipas shariatit të atëhershëm martohej djali që ka lindur më përpara me vajzën që ka lindur më mbrapa dhe e kundërta, pra jo me atë që lindnin bashkë. Por Kabili nuk iu bind këtij rregulli dhe dëshironte të martohej me motrën që kishin lindur bashkë, ngaqë ajo ishte e bukur dhe nuk dëshironte t’ia merrte dikush tjetër. Ai nuk i dëgjoi këshillat e babait të tij, Ademit (a.s.). Dhe për ta zgjidhur këtë, që të dy blatuan nga një kurban. Kur’ani këtë ndodhi e shpjegon kështu: **“Lexoju (Muhammed) atyre (jahudive dhe të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua, ndërsa tjetrit jo. Ai (që nuk iu pranua) tha: “Unë do të të mbys ty.” E ai (që iu pranua) tha: “Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve.”** (Maide, 27) Në këtë ajet shohim që ceket ana shpirtërore më tepër se sa ana materiale.

Në Kur’an shohim edhe një histori tjetër në lidhje me kurbanin dhe është pikërisht historia e Ibrahim

(a.s.) me të birin, Ismailin. Siç dihet hz. Ibrahim ka kaluar disa sprova të vështira. Atij i është dashur të përballet me qafirin e madh, Nemrudin. Gjithashtu është sprovuar me hedhje në zjarr si dhe me bërjen kurban të të birit, Ismailin. Ai këto tri sprova i kaloi me sukses dhe arriti të fitojë titullin “Halil”.

Allahu (xh.xh.) në Kur'anin famëlart urdhëron e thotë: **“Ne e gëzuar atë me një djalë që do të jetë i butë (i sjellshëm).” Dhe kur arriti ai (djali) që sëbashku me të (Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) i tha: “O djali im; unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko pra, ç’mendon ti?” Ai tha: “O babai im, puno atë që të urdhërohet. E ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, të durueshëm!” E kur ata të dy iu dorëzuan urdhërit të Zotit dhe e ktheu atë në fytyrë (përmbys) Ne i thirrëm atij: “O Ibrahim! Ti tashmë e zbatove ëndërrën! Ne kështu i shpërblejmë të mirët! Vërtet, kjo ishte sprovë e qartë. Ne e shpaguam atë me një të therur (kurban) të rëndësishëm. Ne e lëmë atë për kujtim të mirë për popujt e ardhshëm. Selami (shpëtim e paqe) qoftë mbi Ibrahimin.”**

Pa dyshim se kjo që ndodhi

është një sprovë. Dhe të sprovuarit me fëmijë me të vërtetë është diçka e vështirë. Ibrahim (a.s.) në çështjet e tevhidit, haxhit dhe kurbanit, është simboli dhe shembulli për ummetin muliman.

Kurbani është diçka e njohur për njerëzit që nga koha e Adem (a.s.). Ky rit (kurban), qoftë ai që bëhet në haxh apo edhe jashtë tij, ka shumë të mira, si nga ana materiale ashtu edhe nga ana shpirtërore. Me bërjen e kurbanit në rradhë të parë tregohet bindja dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit të Gjithësisë. Nuk është e thjeshtë që një njeri të presë me dorën e vet kafshën që e ka ushqyer po me dorën e vet. Në ibadetin e kurbanit, tregohet shumë qartë se çdo gjë në këtë botë është amanet, dhe se përveç dashurisë ndaj Allahut, asnjë dashuri tjetër nuk është e pakufizuar.

Ashtu si ibadetet e tjera edhe qëllimi i kurbanit është takvaja (devotshmëria). Prerja dhe ndarja e kurbanit, është më tepër një përfitim shpirtëror sesa material. Njëherë kur Pejgamberi (a.s.) preu një kurban, urdhëroi që ta shpërndajnë. Kur u kthye në shtëpi pyeti se ç’ e bënë mishin e kurbanit dhe se sa ka mbetur prej tij në shtëpi. Mori përgjigjen që përveç kurrizit nuk kishte mbetur asgjë tjetër, i gjithi ishte shpërndarë. Atëherë Pejgamberi (a.s.)

tha: “Pse nuk thua që përveç kurrizit i gjithi qënka bërë i yni” (Tirmidhi).

Nga ky hadith kuptojmë që, e jona është ajo pjesë që jepet për hir të Allahut e jo ajo që mbahet për vete.

Jo vetëm prerja dhe shpërndarja e kurbanit, por edhe shitblerja e tij, përbën një gjallëri ndër njerëz. Sepse ka njerëz që i kanë të ardhurat vetëm nga blegtoaria. Kështu që koha e kurbanit është një mundësi e mirë fitimi për këta njerëz.

Ka njerëz që pretendojnë se janë mbrojtës të kafshëve duke mos u pajtuar me prerjen e bagëtive për kurban, me preteksin se janë gjynah të priten. Por qëllimi i këtyre njerëzve nuk është për të ngrënë fruta, por për të rrahur rojën e frutave. Këta tipa flasin sikur nuk priten kurrë bagëti! Vazhdimisht i shohim dyqanet e mishit të mbushur plot me mish bagëtie të prera, edhe jashtë bajramit të kurbanit. Dhe kjo është normale, sepse Allahu (xh.xh.) kështu e ka vendosur rregullin në gjithësi, dikush lind, dikush vdes, dikush pritet, dikush hanë, dikush hahet e kështu me radhë.

Përktheu: **ADEM PIZGA**

Riti i kurbanit, qoftë ai që bëhet në haxh apo edhe jashtë tij, ka shumë të mira, si nga ana materiale ashtu edhe nga ana shpirtërore. Me bërjen e kurbanit në rradhë të parë tregohet bindja dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit të Gjithësisë. Nuk është e thjeshtë që një njeri të presë me dorën e vet kafshën që e ka ushqyer po me dorën e vet. Në ibadetin e kurbanit, tregohet shumë qartë se çdo gjë në këtë botë është amanet, dhe se përveç dashurisë ndaj Allahut, asnjë dashuri tjetër nuk është e pakufizuar.

NGATERRESAT FETARE DHE LUFTRAT E PERGJAKSHME NE HISTORINE E FESE SE KRISHTERE



Edhe gratë që kishin dhembjet e lindjes dhe që merrnin ilaçe janë gjykuar në Inkuizicione, sepse ato konsideroheshin se dilnin kundër frazës që i pat thënë Perëndia Evës: “Do të t’i shtoj më tepër mundimet e shtatzanisë dhe do të lindësh fëmijë mes dhimbjesh”

Tre shekujt e parë të tij, Krishtërimi i kaloi si një fe e ndaluar. Kjo periudhë njihet si “Koha e Dëshmorëve” për arsye se, mbi të krishterët u ushtrua dhunë e torturë nga autoritetet zyrtare. Mirëpo, në vitin 131 me anë të urdhërit të Milanos, kisha e Pjetrit fitoi mbrojtjen e perandorisë dhe në procesin e mëvonshëm u pranua si fe zyrtare. Kisha e Pjetrit, me pretendimin se ishte autoriteti i vetëm në fushën e fesë, e monopolizoi fenë dhe me mbështetjen e plotë të shtetit i quajti heretikë, të gjithë ata që ishin në kundërshtim me ta. Kisha filloi një gjueti për një kohë të gjatë ndaj kundërshtarëve të saj, duke ushtruar më tepër tortura dhe dhunë nga ajo dhunë që ankohej ajo më parë, madje nuk ngurroi ta ushtronte këtë dhunë, edhe ndaj atyre që ndanin të njëjtin besim me të.

Kisha, me këto akte dhune do i vendoste vulën historisë, këto ngjarje do të bëheshin nismëtares e ngatërresave të përgjakshme mes fraksioneve të krishtërimin, të cilat do të vazhdojnë me shekuj me radhë.

Në fund të këtyre ngatërresave, Krishtërimi u nda në fraksione të ndryshme si Katolik, Ortodoks dhe Protestant.

Kisha që kishte marrë mbështetjen e pushtetit, aktin e parë të dhunës në masë, e ushtroi në shekullin e katërt ndaj Doantistëve dhe përkrahësve të Arius-it, Makedonius-it dhe Nestorius-it. Në shekullin V polemizuesi dhe teologu i njohur i krishterë Augustini, përdori i pari konceptin “Luftë me të drejtë”, duke thënë se luftrat e të krishterëve në disa raste ishin të lejuara. Në shekullin e trembëdhjetë, Thomasi e zgjeron më tej këtë koncept, e sistemon atë dhe përfundimisht, në Krishtërim shfaqet koncepti “Luftë e Shenjtë”, ku legjitimoheshin krimet që bëheshin në emër të fesë. (Augustin, Treatise Concerning the Correction of the Donatists, Christian Classics Ethereal Library 2000. nga Şinasi Gündüz, *Hristiyanlıkta Şiddetin Mesruiyet Zemini*, Islamiyat V, 2002, 55-56)

Aktet barbare fillojmë t’i vërejmë pas shekullit të 10-të. Ato ishin ekzekutime pa gjyq, ndaj atyre që dilnin kundër doktrinaeve të kishës,

ushtruar në gjyqet e inkuizicionit, të cilat ishin të ngritura nga papët katolik dhe që kanë zgjatur rreth 6-7 shekuj(1200-1800) në Evropë dhe Amerikën Jugore. (Guy-Jean Testas, *Engjizisyon/Inkuizicioni*, përkth. në turq. Ali Erbaş, 2003, Shtëpia Botuese “Insan”, f. 7-9). Në inkuizicionet e miratuara nga këshilltarët e kishës janë ushtruar tortura nga më të pamëshirshmet, ndaj atyre që dilnin kundër doktrinës së papatit. Nga to përmendim tortura Ordalia, ku dora apo një organ i ngjashëm i të dyshuarit futej në enë me ujë të valuar ose mbajtja e hekurit të skuqur në duar, torturat e metodës së varësës me zinxhir, rrahja me kamxhik të hekurt të sapodalë nga zjarri, torturat e shtypjes së dhëmbëve, nofullave, organeve seksuale, metoda e përbuzjes duke e shëtitur në rrugë të futur në “kafazin e heretikut”, tortura Estratape, lidhja lakuriq për shtyllë duke e lëvizur lart e poshtë, tortura e ujit dhe duke i bërë të ecnin zbatuar mbi thëngjijt e qymyrit, ulje në hu (megjithëse disa priftërinj dolën kundër saj). Pra, nuk kanë nguruar të ushtrojnë tortura nga më të vuajtshmet dhe më turpërueset

(M. Esgin, *Hristiyanlıkta Engizisyon Mahkemeleri/Gjyqet e Inkuizicionit në Krishtërim*, Inst. i Shkenc. Sociale i Univ. Selçuk, tezë e pabotuar e doktoraturës, 1998, Konya, f. 310-319; Guy-Jean Testas, *Engizisyon/Inkuizicioni*, 39-41).

E përsëri pas pyetjeve, gjithmonë nëse i dyshuari jetonte akoma, nuk e pranonte fajin i ushtroheshin tortura të ndryshme duke përfshirë dhe vdekjen. Ndëshkimi më i rëndë me vdekje ishte djegia për së gjalli në turrën e druve. Madje, në disa raste, nxirrej kufoma nga varri dhe digjej. (Esgin, 329 dhe vazhdimi, 353-355; Guy-Jean Testas, 42-46). E njëjta metodë është përdorur edhe nga Perandoria Bizantine, për të shtypur “lëvizjen Bogomile”, e cila ishte shfaqur në Ballkan, ndaj ndjekësve të liderit të kësaj lëvizjeje, Vasilit. (Georg Ostrogorsky, *Bizans Devleti Tarihi/Historia e Shtetit Bizantin*, përkth. në turq. Fikret İşiltan, Ankara, 1999, f. 345). Madje, edhe gratë që kishin dhembjet e lindjes dhe që merrnin ilaçe janë gjykuar në Inkuizicione, sepse ato konsideroheshin se dilnin kundër frazës që i pat thënë Perëndia Evës: “Do të t’i shtoj më tepër mundimet e shtatzanisë dhe do të lindësh fëmijë mes dhimbjesh” (Bibla, Zanafilla, 3/16). (Bernard Russell, *Din ve Bilim/Feja dhe Shkenca*, f. 78)

Në pamundësi të kushteve të kohës së atëhershme, shifrat nuk janë të qarta, por mendohet të kenë vdekur të paktën, afro gjysmë milion njerëz, (afërsisht pesëdhjetë mijë me dënimin me djegie) dhe 5 milion vetë të dëbuar (Esgin, 363). Këto ngjarje janë rregjistruar në histori, si dosja e zezë e kishës katolike të Papës dhe si barbarizëm njerëzor.

Një tjetër dhunë dhe terror masiv janë aktet e Kryqëzatave. Ndërkohë, që papët jetonin në luks dhe të qetë, me paratë e tokave të parajsës që ua kishin shitur njerëzve në këmbim të shërbesës të shlyerjes së mëkatit, populli i varfër dhe i pambrojtur, bashkë me kalorësit aventurierë,

me premtimin se do të meritonin parajsën, do të merrnin tokat e shenjta dhe pasuritë e botës Islame, do të bëheshin shkaktarët e mëdhenj të krimeve monstruoze, të njohur në histori, si Kryqëzatat. Rrugës, në vendet ku kalonin, këto turma të mashtruara e të uritura, bënë krimet më të tmerrshme duke

Në pamundësi të kushteve të kohës së atëhershme, shifrat nuk janë të qarta, por mendohet të kenë vdekur të paktën, afro gjysmë milion njerëz, afërsisht pesëdhjetë mijë me dënimin me djegie dhe 5 milion vetë të dëbuar. Këto ngjarje janë rregjistruar në histori, si dosja e zezë e kishës katolike të Papës dhe si barbarizëm njerëzor.

vrrarë njerëz të pafajshëm, pa bërë dallim në ishin fëmijë, gra apo të moshuar. Dëshmitarët e asaj kohe që kanë parë krimet e Kryqëzatave që kanë hyrë në Jeruzalem, tregojnë se si pasojë e gjakut të derdhur, kufomat notonin mbi një det të përgjakshëm ku rridhte gjaku lumë dhe se gjithandej gjendeshin koka, krahë e këmbë të prera. Bashkë me myslimanët, të njëjtin fund kanë pasur edhe hebretë dhe të krishterët që nuk ishin katolikë. (Reşit Turnagil, *İslamiyet ve Milletler Hukuku/E drejta Islame dhe e drejta ndërkombtare*, f. 140-143).

Përplasjet e vijuara me shekuj mes Kishës Katolite të Romës

dhe Bizantit Ortodoks për arsye të dallimeve politike, kulturore dhe fetare, kanë përfunduar duke shkishëruar njëra-tjetrën. Papa dhe Patriku i dhanë fund përjetësisht ndarjes mes dy kishave duke akuzuar njëri-tjetrin me “devijim dhe heretizëm”. Për këtë arsye, beteja e katërt e Kryqëzatave u zhvillua në Kostandinopojë (1204), qyteti u plaçkit, u shkatërruan vendet e shenjta të Ortodoksve, u varën priftërinj dhe u fye posti i Patrikanës duke kënduar këngë mbi të gra imorale. (Olivier Clement, *Din Fenomeni* përkth. në turq. Mehmet Aydın, f. 205). Veçanërisht, thesaret e vyera të qendrës kulturore më të madhe në botë të asaj kohe, kaluan në dorën e pushtuesve dhe shumë prej tyre, u rrëmbyen dhe u dërguan për në Evropë. Vetëm para disa viteve Patrikhanës u kthyen mbrapsht nga Vatikani plaçkat e disa të shenjtëve. Kjo gjë pati bërë të thellohet më tej urrejtja dhe mllefi mes dy kishave, derisa një Bizantin i quajtur Niketas Khoniates pati thënë “*Latinët e mallkuar... U rrjedh goja lëng për mallrat tona, duan të na shkulin me rrënjën... Mes nesh është një humnerë e madhe mllefi. Eshtë e pamundur të bashkohemi me ta, jemi shumë të ndryshëm*” (Ostrogorsky, 361-362) Ndërsa një tjetër historian bizantin do të thoshte “*Ismailët (arabët myslimanë) janë më miq me njerëzit dhe më të mëshirshëm në krahasim me këta njerëz që varin kryqin e Jezusit në shpinë*” (Ostrogorsky, 386). Përsëri sipas shpjegimit të historianit bizantin Dukas, një oborrtar bizantin me gradë të lartë, i cili pasi kishte parë ritualin fetar, sipas rimit Katolik, të bërë më 12 Dhjetor 1452 me qëllim bashkimin me

Katolikët para çlirimit të Kostandinopojës arriti të thotë: “Pëlqej të shoh në mes të Kostandinopojës çallmat e Osmanëve, se sa kapelen e priftërve Latinë” (Ostrogorsky, 523-524).

Pas rënies së shtetit Andaluzian të Spanjës, pas viteve 1490 sërish Papati qëndron pas genocidit dhe internimeve masive të ushtruara kundrejt Hebrejve dhe Myslimanëve. Përpjekjen e ashtuquajtur Reconquista (rikonvertimi në të krishterë), Papati e vlerësoi si vazhdim të luftës së Kryqëzatave, ku Papa Clement II me datë 12 Prill 1525 në letrën drejtuar mbretit Karlos i qe shprehur se ishte mjaft i mërzhitur që në këto toka po bashkëjetohej me popullin mysliman dhe sipas tij, urgjentisht i duheshin dorëzuar inkuizicionit. Përfundimisht, shumë qytete myslimane patën ngelur pre e pushtimeve të përgjakshme dhe qenë detyruar të zgjidhnin; ose të mërgonin, ose të bëheshin të krishterë, ose të vriteshin. Me një eksperiencë prej 700 viteve, u shkatërrua qendra e qytetërimit dhe e shkencës një ndër më të mëdhatë në botë për atë kohë, dhe me qindra mijëra libra u dëgjon. Misionarët e rrymës Cluny, të dërguar në këtë zonë, u përpoqën të kristianizonin me dhunë myslimanët, duke fyer Islamin me pohime shumë të shëmtuara dhe të pacipa rreth Islamit dhe Hz. Muhammedit (a.s.). Në këtë kontekst, myslimanët u detyruan me dhunë të kristianizoheshin duke u përdorur parulla “*Duhen pagëzuar qentë*”, “*Vdekje myslimanëve*” në kisha e në stalla bagëtish. Madje, pasi i kristianizuan, u vunë emrin

“Moriscos” që do të thotë “Myslimanë të vegjël”. Prindërit nuk kishin ç’ të bënin tjetër veçse të vështronin me sy të mbushur me lotë ceremoninë e adhurimit të kryqit nga ana e fëmijëve të tyre (Mehmet Özdemir, İspanya Krallığının Hıristiyanlaşırma Politikası, Rev. e Fak. Teologjik e Univ. Ankara, vol. XXXV, 1996, 243-284).

Ndërsa, në anën tjetër të botës, në të njëjtët vite, nën sundimin Osman, jomyslimanëve që

Papa Clement II me datë 12 Prill 1525 në letrën drejtuar mbretit Karlos qe shprehur se ishte mjaft i mërzhitur që në këto toka po bashkëjetohej me popullin mysliman dhe sipas tij, ata urgjentisht i duheshin dorëzuar inkuizicionit. Përfundimisht, shumë qytete myslimane patën ngelur pre e pushtimeve të përgjakshme dhe qenë detyruar të zgjidhnin; ose të mërgonin, ose të bëheshin të krishterë.

jetonin në Anadoll dhe Ballkan në sajë të të drejtave që gëzonin u ishte mundësuar një liri e plotë fetare. Fatih Sulltan Mehmeti i kishte dhënë të drejta Patrikanës më shumë se të gjitha të drejtat që i ishin dhënë në kohën e Bizantit dhe siç shprehen historianët perëndimorë Patrikana ishte bërë “*shtet brenda shteti*”. (Engelhardt, *Tanzimat*, përkth. në turq. Ayda Düz, İst., Botimet Milliyet., f. 91) Provat më të gjalla konkrete janë Manastiret Ajnaroze (*Ajion Oros*) në Greqi, të cilat kanë qëndruar në këmbë si pasojë e të drejtave

që gëzonin prej një mijë vitesh, gjithashtu edhe manastiret e panumërta në Stamboll dhe në Ballkan dhe ndoshta argumenti më i mirë janë popujt e krishterë të Ballkanit. Ashtu sikur u bë në Spanjë, Perandoria Osmane, e cila sundoi 500-600 vite me radhë në këtë zonë, sikur të kishte ushtruar ndonjë genocid (megjithëse, ngaqë ishte në epokën më të fuqishme të saj nuk kishte ndonjë shtet që mund t’i dilte kundër për këtë), ashtu sikur ne, sot nuk mund të flasim për një popull mysliman në Spanjë, nuk duhej të ishte e mundur të bënim fjalë aktualisht për popujt të krishterë në Ballkan.

Papati bie në kundërshtim me dogmën e krishterë “*nuk ka ndonjë të vërtetë/shpëtim tjetër përveç kishës*”, me këtë ide të pabazuar as në logjikë, as në shkencë, me shekuj të tërë i ka dhënë drejtim masës së gjerë. Shembulli më i bukur për këtë është thënia “*bota rrotullohet*” e Galileu-t (v. 1642), gjë, e cila e bëri të burgosej dhe vetëm duke rrëfyer se kishte kthyer mendje, mundi të shpëtojë. Mirëpo, mendimtarët dhe teologët e njohur të kohës, Giordano Bruno (v. 1600), Jan Huss (v. 1415) dhe shumë shkencëtarë nuk mundën të ishin me fat si Galileu, sepse u dogjën të gjallë në turrën e druve. (Gündüz, 42).

Nga këto akte të palogjikshme të Papëve, masat e gjëra popullore u detyruan të hidheshin në kryengritje të shumta dhe për pasojë bënë që Perëndimi të ftohej ndaj fesë, t’i drejtohej ateizmit dhe të mbijnë mendime kundër fesë. Kurse ata që kishin ngelur fetarë, sikur është Martin Lutheri, shpalosën flamurin e kryengritjes ndaj tyre dhe

përdorën forcën dhe përfundimisht u shfaq “Protestanizmi”, kështu në botën e Krishterë u përjetua lëvizja e dytë e madhe e ndarjes. Në këtë betejë, Lutheri e quante papën “Antikrisht”.

Themeluesi i Protestanizmit, Lutheri, i cili konsiderohej si përkrahës i lirisë, nuk i mungonte ndjenja e armiqësisë. Për myslimanët/turqit, të cilët i konsideronte si kundërshtarë të Mesihut, ai shprehej kështu: “*Ne nuk mund t’i mundim ata, përderisa nuk përdorim shpatat tona mbi ta dhe mbi dijetarët e tyre*” (L.Hagemann, Martin Luther ve İslam Anlayış, përkth. në turq. K. Kahramantürk, İzmir, 2000, f. 10 dhe vazhdimi). Këto fjalë të tij që e shenjtërojnë luftën janë mjaft interesante: “*Të shkosh në luftë dalëngadalë, nuk është vepër e dashurisë që bën një i krishterë, secili duhet t’u prejë kokën armiqve, duhet t’i plaçkisim e t’i djegim dhe duhet të përdorim të gjitha mënyrat derisa t’i mundim ata... Vetëm një i marrë mund të pranohet se të presësh koka dhe të mbledhësh pre lufte bie në kundërshtim me Krishtërimin dhe me principin e dashurisë. Kjo është dashuria e vërtetë.*” (Marrë nga Gündüz, 43) Lutheri edhe në kryengritjen e fermerëve qëndroi në krahun e princave dhe mbrojtë ligjshmërinë e vrasjes së popullit.

Lutheri, që ishte me origjinë gjermane është bërë burim frymëzimi për mendimet dashakeqase ndaj Hebrejve dhe feve të tjera.

Në vitin 1618, perandori austriak, Ferdinandi II, filloi një lëvizje për t’i kthyer reputacionin e humbur katolicizmit për një kohë të shkurtër, kjo lëvizje mori përmasa të mëdha dhe në histori

ngeli me emrin e njohur “luftat 30 vjeçare”(1618-1648). Ajo u bë skenë e luftave të përgjakshme, ndërfraksionare ku humbën jetën me mijëra njerëz.

Me perandorinë koloniale që themeluan shtetet Evropiane në Afrikë, ndërkohë që u merrnin pasuritë mbitokësore dhe nëntokësore, gjithashtu edhe misionarët, në këmbim të tokave

Kisha që kishte marrë mbështetjen e pushtetit, aktin e parë të dhunës në masë, e ushtroi në shekullin e katërt ndaj Doan-tistëve dhe përkrahësve të Arius-it, Makedonius-it dhe Nestorius-it. Në shekullin V polemizuesi dhe teologu i njohur i krishterë Augustini, përdori i pari konceptin “Luftë me të drejtë”, duke thënë se luftat e të krishterëve në disa raste ishin të lejuara. Në shekullin e trembëdhjetë, Thomasi e zgjeron më tej këtë koncept, e sistemon atë dhe përfundimisht, në Krishtërim shfaqet koncepti “Luftë e Shenjtë”, ku legjitimoheshin krimet që bëheshin në emër të fesë.

bënin pazar me Ungjillin. Si rrjedhojë, shkaktarët e urisë dhe varfërisë së këtyre shteteve, në kohët e sotme janë pikërisht Papët e krishterë dhe klerikët e tyre.

Gjithashtu edhe për dy luftat botërore të shekullit të 20-të, në të cilat vdiqën me miliona njerëz, elementet e krishterë kanë qenë përgjegjës kryesorë. Në një

mënyrë është përzier edhe kisha në to, pasi edhe Kisha Anglikane, Luftën e Parë Botërore e konsideronte si një luftë mes Mbretërisë së Perëndisë dhe djallit (Gjermanisë). (R.G. Jhones, *Groundwork of Christian Ethics*, London, Epworth Pres, 1984, 86). Për ironi të fatit, gjatë Luftës së Dytë Botërore, emri i projektit të bombave atomike që hodhi SHBA në Japoni ishte “Trinitet” (Ahmed Davudoğlu, *Revista Divan İ. A.*, 2000/2, f. 289). Si pasojë e saj vdiqën qindra mijëra njerëz, dhe për më tepër pati pasoja mutacioni mbi foshnjat e palindura dhe mbi mjedisin ku thuhet se edhe në ditët e sotme nuk gjelbërojnë bimë.

Mirëpo është shumë e çuditshme se të gjitha këto krime të bëra, qoftë mes njëri-tjetrit, qoftë ndaj të tjerëve janë bërë në emër të Jezusit Mesih, për të fituar dashurinë e tij. Domethënëse, nga Ungjilli që sot përpiqen të nxjerrin vetëm dashuri, paqe, mirësi e vëllazëri, nuk del vetëm dashuri e mëshirë! Sidoqoftë, kisha dhe papati, me cilësinë e “pagabueshmërisë” gëzojnë çdo të drejtë administrative; kë dëshirojnë të vendosin në parajsë e kë dëshirojnë e nxjerrin prej aty dhe mëkatet ua falin menjëherë. Ashtu siç e pamë edhe më lart, megjithëse në Ungjill gjenden fraza si “*duajini edhe armiqët*”, kjo nuk ndaloi që të mos përjetohen gjakderdhje të tilla të papara në historinë e njerëzimit!

Përktheu: **Artur Tagani**



Haxhi i pranuar dhe umreja

Ata që kryejnë Haxhin dhe umren me zemër të paqtuar në ato toka të bekuara, të mbushura plot me kujtimet e shenjta të vargut të profetëve, të ushqyera me përrshpirtshmërinë e zemrave besimtare dhe të vaditura me lotët apasionantë, frymëzohen nga shumë e shumë kujtime të bekuara të pejgamberëve. Adhurimet e haxhit dhe umres që kryhen në ato vende të shenjta janë pretekste të rralla të përparimit në jetën e njeriut si rob i Zotit. Gjatë haxhit robi i Zotit i kujton vetes të qënët e tij asgjë përballë madhësisë hyjnore, ndërsa me ihramin që vesh, përjeton thellë brenda një delikatesë shpirtërore dhe mejtimi, duke hyrë kështu në një lloj klime prej qefini. Nga ky aspekt, ndoshta përfitimi më i rëndësishëm në haxh është ringjallja e zemrës duke jetuar me dhjetëra herë enigmën e fjalëve “të vdesësh përpara se të vijë vdekja” dhe të rrethohesh nga ekstaza e ftesës hyjnore “Kthehu tek Zoti yt...”


Familjes së madhe njerëzore që zë fill me Hz. Ademin dhe Havanë (a.s.) i është caktuar si vendadhurimi Qabja dhe rrethina e saj që gjenden në Mekke, në mënyrë që të jetojnë në klimën e prehjes dhe lumturisë fetare. Bijtë e Ademit (a.s.) u shpërndanë në vende të ndryshme për shkaqe të ndryshme jetësore e sociale dhe kështu, me kalimin e shekujve, brezat ndryshuan, humbën rrugën e drejtë në besim dhe pas njëfarë

kohe ajo faltore e shenjtë humbi. Hz. Ibrahim (a.s.) e ndërtoi sërish atë me urdhërin që mori nga Allahu (xh.sh.) dhe në sajë të lutjes që pat bërë, u kthye në pretekst të begatimit të atyre tokave.

Në ajetin kur'anor thuhet:

“Përkujto kur Ibrahim tha: Zoti im! Shndërroje këtë qytet në qytet të sigurtë dhe na mbro mua dhe bijtë e mi nga adhurimi i idhujve. Zoti im! Nuk ka dyshim se idhujt i shmangin njerëzit nga rruga e drejtë. Kush më pason mua ai është me mua (në fe). Kush del kundër meje (atëherë) Ti je Ai që fal dhe mëshiron pa masë. O Zoti ynë! Unë e vendosa një pjesë të pasardhësve të mi pranë Shtëpisë Tënde të Shenjtë, në një luginë të zhveshur nga frutat, në mënyrë që ata të mund të falin namazet siç duhet. Bëj që njerëz zemërdhembshur të aviten drejt tyre dhe begatoji ata me ushqim frutash. Shpresoj se ata do të dinë të të falënderojnë për këto begati të dhuruara.” (Ibrahim, 35-37)

Më së fundi pat ardhur edhe shekulli i lumtur dhe jeta fetare në saj të veprimtarisë së Profetit Muhammed (a.s.), qe ngritur në pedestal. Profeti ynë (a.s.) pat jetuar dhe qe bërë shkak që edhe të tjerët të jetojnë një shekull të lumtur me qendër Mekken dhe Medinen e kështu, ato qytete me rrethinat e tyre u shndërruan deri në kiamet në



tokën e bekuar, ku rreh pulsi i Islamit dhe myslimanëve.

Ata që kryejnë Haxhin dhe umren me zemër të paqtuar në ato toka të bekuara, të mbushura plot me kujtimet e shenjta të vargut të profetëve, të ushqyera me përsjirtshmërinë e zemrave besimtare dhe të vaditura me lotët apasionantë, frymëzohen nga shumë e shumë kujtime të bekuara të pejgamberëve. Adhurimet e haxhit dhe umres që kryhen në ato vende të shenjta janë pretekste të rralla të përparimit në jetën e njeriut si rob i Zotit. Gjatë haxhit robi i Zotit i kujton vetes të qënët e tij asgjë përballë madhësisë hyjnore, ndërsa me ihramin që vesh, përjeton thellë brenda një delikatesë shpirtërore dhe mejtimi, duke hyrë kështu në një lloj klime prej qefini. Nga ky aspekt, ndoshta përfitimi më i rëndësishëm në haxh është ringjallja e zemrës duke jetuar me dhjetëra herë enigmën e fjalëve “*të vdesësh përpara se të vijë vdekja*” dhe të rrethohesh nga ekstaza e ftesës hyjnore “**Kthehu tek Zoti yt...**”(el-Fexhr, 28)

Përveç kësaj, ata që Ata që vishen me ihram, për shkak të ndalimit të kryerjes në kohë të caktuara të disa akteve që në jetën e përditshme janë të lejuara, e përjetojnë edhe në një formë tjetër thirrjen se sa larg duhet të qëndrojnë nga haramet dhe gjërat e aktet e dyshimta. Nga ana tjetër, me ndalimin e akteve siç janë këputja e barit, gjuetia, të treguarit gjahtarëve se ku ndodhet preja, ata mbërrijnë një ndjeshmëri të besimit të mbushur përplot me mëshirë, delikatesë dhe hijeshi.

Ashtu sikurse ndodh me të gjithë adhurimet e tjera, të mund të kryesh me një konsistencë që do të bëhet shkak për pranimin e tyre në audiencë n hyjnore, edhe tek adhurimet e haxhit dhe umres kjo shkallë është pasojë e horizontit të besimit dhe kulturës shpirtërore. Sepse të kryesh me rezultatin “**e pranuar**” Haxhin dhe umren është shkak purifikimi nga mëkatet dhe fitimit të pëlqimit të

Allahut (xh.sh.). Pra, rezultati që dëshirohet të arrihet me kryerjen e këtyre adhurimeve arrihet vetëm me çuarjen në vend të tyre me një konsistencë nga e cila Allahu (xh.sh.) është i kënaqur.

Kriteret kryesore që duhen respektuar në mënyrë që haxhi dhe umreja të **pranohen** në audiencën e Allahut janë këto:

1. Të bërët nijet me sinqeritet për kryerjen e haxhit dhe largimi nga aktet dhe tendencat që bien në kundërshtim me të .

Për të fituar pëlqimin Hyjnor dhe që të përfitojmë nga begatitë e Zotit teksa bëjmë një nijet të sinqertë për fillimin e haxhit dhe zotohemi para Allahut të Lartësuar në këtë çështje, duhet të mund t’u vëmë vulën e anulimit marrëveshjeve epshore dhe dobësive njerëzore që kanë zënë vend brenda nesh që të mund të renditemi në të ftuarit e pallatit të të fshehtave hyjnore. Në mënyrë të veçantë në ato vende të bekuara, duhet të rrokim librin e gjithësisë dhe të zhvishemi nga egoizmi. Pikërisht ata që drejtohen për nga haxhi dhe umreja me një ndjesi shpirtërore të tillë, kalojnë nga porta e fitimit të mëshirës dhe begatisë hyjnore. Pas këtij akti, ajo që ata duhet të kryejnë është:

2. Të heqim edhe rrobat e vaniteteve teksa zhvishemi për të veshur ihramin.

Si një shfaqje e marrëveshjes shpirtërore, sinqeritetit dhe principalitetit të treguar në këtë pikë drejt rrugës së kryerjes së haxhit dhe umresë për hir të pëlqimit të Allahut është jo vetëm zhveshja e rrobave të përditshme për të veshur ihramin, por edhe veshja e rrobës së përkushtmërisë duke u zhveshur kështu nga pasionet e kësaj bote siç janë: pasuria, posti dhe pozita në mënyrë që zemrat të marrin hise nga të fshehtat dhe shfaqjet hyjnore. Sepse Allahu (xh.sh.) ka urdhëruar e thënë:

“Kanë shpëtuar ata që e kanë purifikuar



botën e tyre të brendshme.”
(esh-Shems, 9)

Në atë klimë të shenjtë duhet që zemrat t’i lidhim pas Allahut (xh.sh) dhe të shmangim preokupimin me punë të kësaj bote dhe nga shëtitjet përgjatë tregut e pazarit, me përjashtim të rasteve të domosdoshme. Sepse kur humbim në punë të këtilla, në zemra dhe shpirtëra duken shenjat e indiferencës e kështu vështirësohet përfitimi nga klima natyrore e atyre tokave të bekuara. Për këtë arsye Hz. Umeri (r.a.) u këshillonte atyre që kryenin detyrën e haxhit apo umres që të ktheheshin menjëherë në shtëpitë e tyre pasi të kryenin këto adhurime, në mënyrë që ndjenjat e tyre të madhërimit të mos vyshkeshin dhe të mos bënin ndonjë gjest të pakontrolluar.

Në ato vende duhet të kërkojmë Zotin e Qabes dhe të zhytemi në kuptimin e realitetit se **“Allahu është afër robërve të tij më shumë se damari i qafës”** (Kaf, 16). Gjithashtu në përputhje me ajetin fisnik se **“Allahu hyn mes njeriut dhe zembrës së tij”** (Enfal, 24) duhet ta ndërjegjsojmë veten se asgjë nuk mbetet e fshehur përpara Tij. Duhet të zhvishemi nga dashuritë batica-zbatica të kësaj bote dhe duhet të tregojmë kujdes që zemra të jetë bashkë me Zotin. Sepse thelbi i haxhit dhe umresë është:

3. Purifikimi fiziologjik dhe shpirtëror

Teksa shprehet rreth rezultatit që përftohet me rastin e kryerjes së akteve të mira që bëhen

brenda kuadrit të adhurimeve të haxhit dhe umresë i Dërguari i Allahut urdhëron e thotë kështu rreth synimit të kryerjes së adhurimeve në këto toka të bekuara:

“Kryejeni Haxhin! Sepse një haxh (i pranuar) i pastron mëkatet ashtu sikur i pastron uji fëlliqësirat.” (et-Tergib ve’t-Terhib)

Kur çështja ka të bëjë me një pastrim të tillë pa dyshim që një tjetër pikë që duhet të respektojnë dhe të tregojnë kujdes udhëtarët e Hixhazit është edhe:

4. Hyrja me edukatë brenda Haremit Fisnik dhe respektimi i simboleve fetare duke hequr dorë nga kryerja e haremeve dhe dyshimeve.

Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë:

“Muajt e haxhit janë në muajt e ditur. Kush e kryen haxhin në këta muaj të mos kryejë akte të ndaluara, grindje dhe mos të kryejë akte seksuale me gratë e tyre. Allahu i di aktet e mira që kryeni. Bëni gati furnizimet me këtë rast. Me të vërtetë furnizimi më i mirë është devotshmëria. O ju të zotët e mendjes, kini drojë përpara Meje.” (el-Bekare, 197)

Përveç ndalesave të njohura siç janë dëshirat e pshore, mëkatet e mëdha, shkeljet ligjore fetarisht, debatet, duhet të tregojmë kujdes që të mos lëndojmë fizikisht e shpirtërisht asnjë njeri. Kjo është kuptimplote po të mendojmë numrin e madh të njerëzve që gjenden aty, situatë ku haxhilerët



Duhet mos ta heqim nga mendja asnjë çast faktin se në ato toka është e ndaluar të këpusësh edhe një fije bari në mënyrë që aktet njerëzore që i kryejmë me delirin e adhurimit të na afrojnë tek Allahu dhe që sjelljet e rënda dhe të ashpra t’ua lënë vendin dashurisë, mëshirës, respektit, delikatesës dhe hijeshisë.

çdo moment mund të lëndojnë njëri-tjetrin. Për të shmangur një gjë të tillë në mënyrë të veçantë gjatë kryerjes së tavafit duhet të tregojmë kujdes ndaj respektit dhe delikatesës. Duhet të mos u

shkaktojmë shqetësime atyre që bëjnë tavafin duke dalë në drejtim të kundërt me vijën e rrotullimit.

Veçanërisht duhet të shmangen me përpikmëri të madhe përzierja mes burrave dhe grave brenda gjithë atij kallaballëku njerëzish në Haremin Fisnik dhe në ashensorët e hoteleve; në hije dhe zbritje duhet të jemi të rregullt dhe dinjitozë. Duhet mos ta heqim nga mendja asnjë çast faktin se në ato toka është e ndaluar të këpusësh edhe një fije bari në mënyrë që aktet njerëzore që i kryejmë me delirin e adhurimit të na afrojnë tek Allahu dhe që sjelljet e rënda dhe të ashpra t'ua lënë vendin dashurisë, mëshirës, respektit, delikatesës dhe hijeshisë.

Këto lloj ndjenjash delikate janë imtësi mbi të cilat na e ka tërhequr vëmendjen veçanërisht i Dërguari i Allahut (a.s.) i cili është përmendorja e rrallë e mëshirës dhe delikatesës. Sepse i Dërguari i Allahut (a.s.) një ditë i pat thënë kështu Hz. Umerit:

“O Umer! Ti je njeri me trup të fuqishëm. Mos i shkakto shtypje trupdobëtit (duke menduar të shkosh të puthësh

Haxheru’l-esvedin). Po qe se sheh se shtylla është e zbrazur afroju asaj, nëse nuk është thirr tekbinin dhe kalo!..” (Ibn Hanbel, I, 23)

Në këtë mënyrë së bashku me respektimin e së drejtës së robit i duhet treguar shumë kujdes edhe edukatës së jashtme dhe të padukshme ndaj atyre vendeve të bekuara, sepse një nga qëllimet e kryerjes së haxhit është ngritja shpirtërore e zemrave që frymëzohen me respektin e atyre vendeve të bekuara dhe kujtimin e posteve të shenjta që gjenden atje. Në ajetin fisnik thuhet:

“...Nuk ka asnjë dyshim se ata që tregojnë respekt ndaj simboleve të Allahut këtë e bëjnë për shkak të përschpirtshmërisë së tyre.” (el-Haxh, 32)

Në këtë kuptim Kur’ani Fisnik, ezani muhammedije, Qabeja e madhëruar dhe sa e sa vende të shenjta si për shembull kodrat e Safasë dhe Merves janë që të gjitha në vlerën e simboleve të Allahut. Jo vetëm që nuk duhet treguar mangësi në ndjenjën e respektit ndaj tyre gjatë haxhit dhe umres, por në mënyrë të veçantë duhet treguar edukatë ndaj tyre. Duhet treguar kujdes

të shmangen sjellje të pahijshme siç janë ulja me këmbët drejtuar nga Qabja, shtrirja kundrejt saj, të diskutuarit e gjërave të kota apo që nuk të interesojnë, të lexuarit e Kur’anit në mënyrën që nuk i ka hije atij dhe vendosja e tij në vende ku nuk i takon.

Nga ana tjetër duhet që në ato vende të bekuara të përpiqemi të kuptojmë vëllezërit tanë besimtarë që sëmuren, mbesin në rrugë, u harxhohen paratë që kanë, humbasin të afërmit e tyre apo që bien në situata të tilla të vështira dhe t’u gjejmë derman halleve të tyre. Duke mbajtur në mend faktin se shpirtërat janë vendvërojtimi hyjnor le të përpiqemi të mos thyejmë zemrat e njerëzve, por t’i fitojmë ato. Sepse dritaret e zemrave janë të hapura për Allahun dhe të shumtën e herëve nuk mund të dimë se me çfarë grade shpirtërore është personi që hasim.

5. Ta bësh thëror vullnetin për hir të kënaqësisë hyjnore.

Me të vërtetë që synimi thelbësor në prerjen e kurbanit gjatë adhurimit të haxhit është përkujtimi i aktit të dorëzimit që treguan Hz. Ibrahim (a.s.) dhe Ismaili (a.s.), marrja pjesë nga



Në ato vende të bekuara duhet të përpiqemi të kuptojmë vëllezërit tanë besimtarë që sëmuren, mbesin në rrugë, u harxhohen paratë që kanë, humbasin të afërmit e tyre apo që bien në situata të tilla të vështira dhe t’u gjejmë derman halleve të tyre. Duke mbajtur në mend faktin se shpirtërat janë vendvërojtimi hyjnor le të përpiqemi të mos thyejmë zemrat e njerëzve, por t’i fitojmë ato. Sepse dritaret e zemrave janë të hapura për Allahun dhe të shumtën e herëve nuk mund të dimë se me çfarë grade shpirtërore është personi që hasim.

urtësia hyjnore e tyre dhe lartësia e shpirtërave në pikën e të qenit rob i Allahut sipas principalitetit. Pra duhet të gjendemi brenda thirrës së një dervishi që zhvishet nga ekzistencializmi material, që nuk i dhuron asnjë vlerë vetvetes, që ia dorëzon vullnetin e tij Allahut dhe që digjet në zjarrin hyjnor. Sepse Allahu (xh.sh.) thotë:

“As mishi dhe as gjaku i kurbanit nuk mbërrin tek Allahu. Ajo që shkon tek Zoti juaj është vetëm devotshmëria juaj...” (el-Haxh, 37)

Duhet të mendojmë se Ibrahim (a.s.) që i gatshëm të sakrifikoje birin e tij, ndërsa i biri Ismaili (a.s.) që i gatshëm ta bënte veten theror. Sa mund ta shpërblejmë ne vetveten dhe pasurinë tonë në rrugën e Allahut (xh.sh.)? Sa arrijmë të meritojmë cilësinë e **“besimtarëve që i shesin shpirtat dhe pasuritë e tyre përkundrejt xhenetit”** siç thuhet në ajetin fisnik?

Ja një detyrë që bie mbi ne gjatë tërë jetës për hir të kësaj sakrifice:

6. Të gjuajmë me gur shejtanin dhe egon.


Të gjuajmë me gur shejtanin, më tepër nis me gjuajtjen gurë të shejtanit që kemi brenda nesh. Ky akt është përkujtimi i gjuajtjes me gurë shejtanit që bëri Ibrahim (a.s.), Ismaili (a.s.) dhe nëna jonë Haxheri, për shkak të cytjeve të tij.

Shkalla dhe konsistenca që kërkohet që të mbërrijë robi i Zotit duke kaluar të gjitha këto etapa është:

7. Të jesh vazhdimisht në dhikr dhe në lutje ndaj Zotit.

Allahu i Lartësuar urdhëron dhe thotë:

“... Kur të ndaheni dhe vërshoni prej Arafatit përmendeni Allahun në vendin e shenjtë (Muzdelife) dhe



përmendeni ashtu siç u ka mësuar. Pa dyshim se ju më përpara ishit nga të humburit.” (el-Bekare, 198)

“Kur ti kryeni detyrat tuaja përmendeni Allahun siç bënin të parët tuaj, madje më shumë se sa ata. Ka nga njerëzit që thonë: “Zoti ynë dhurona neve vetëm në këtë botë!” Ata nuk fitojnë asgjë në botën tjetër” (el-Bekare, 200)

Sepse edhe telbija që urdhërohet të këndohet herë pas here në haxh dhe umre është evokim i të qëndruarit vazhdimisht në gjendjen e dhikrit dhe lutjes.

I Dërguari i Allahut (a.s.) i ka sqaruar me këto fjalë, madje edhe se si duhet të flitet në adhurimet jashtë adhurimeve që bëhen në vende të bekuara në mënyrë që të ruhet gjëndja e dhikrit dhe lutjes:

“Tavafi rreth Qabes është si namazi. Por këtu mund të flisni. Vetëm se kush flet gjatë tavafit le të flasë veç fjalë të mira.” (Tirmidhi, Haxh, 112)

Ajo që synohet në përfundim të kryerjes së këtyre rregullave që i numëruam deri këtu është:

8. Zemra të shijojë faljen, frymëzimin dhe shpërblimin hyjnor.

Në hadithin fisnik thuhet:

“Një umre është falje mëkatesh (kefaret) për ato që kryen deri në umren tjetër. Nuk ka shpërblim tjetër për një haxh të pranuar tek Zoti përveç se hyrje në xhennet!” (Buhari, Umre, 1)

Pikërisht dëshira e çdo zemre besimtari që shkon në Haremejn

është përkryerja e haxhit dhe umres me një shtet të tillë dhe të mbërrirë të marrë pjesë dhe hise nga ato që ofrohen në kuadrin e këtij lajmi ogurmirë.

Vizita e Medinës së Përndritur

Nuk duhet harruar se Medineja e Përndritur që vizitohet para apo pas haxhit dhe umresë mban në gjë perlën më madhështore të gjithësisë. Me emocionin që të fal përkatësia në bashkësinë e tij duhet të tregohet një edukatë krejt e veçantë në këtë rast.

Sepse i Dërguari i Allahut ka thënë:

“... Ashtu sikur se Ibrahim i shpalli Mekken zonë të ndaluar dhe u lut për të edhe unë e shpalla Medinen zonë të ndaluar (harem)...” (Buhari, Fedailu’l-Medine, 6)

Për këtë arsye ai respekt që tregohet ndaj Mekkes duhet të tregohet edhe ndaj Medines. Imam Maliku dhe dijetarët e Medines janë të një mendimi kur thonë se Medineja është më e vyer se Mekkeja dhe se vendi ku gjendet varri i Pejgamberit (a.s.) është qoshja më e shenjtë në rruzullin tokësor (Shih Kadi Ijad, *Shifau’sh-Sherif*, vëll. II, fq. 95–96). E

tërë gjithësia është krijuar për hir të tij dhe i është dedikuar atij.

Si një shfaqje të kësaj delikatese edhe imam Maliku që qe imam i Xhamisë së Profetit nuk hipte mbi kafshë dhe madje nuk veshte as këpucë në Medine si shenjë respekti në tokat ku kanë shkelur këmbët e Profetit (a.s.).

Që ata që kryejnë Haxhin dhe umrenë të mund të fitojnë nga kujtimet e shenjta të asaj klime është e domosdoshme të rrethohen nga ndjenjat e edukatës dhe respektit për ato vende të madhëruara, sepse kushti i parë i përfitimit shpirtëror të vërtetë është edukata.

Shkurtimisht virtytet që i fal zemrave besimtare një haxh dhe umre e pranuar janë të panumërta. Nuk mund të ketë përfitim siç duhet po qe se nuk e respektojmë edukatën ndaj haxhit dhe umresë dhe të kalohet kohë indiferente në ato vende të bekuara.

Arkitekti shpirtëror i Pakistanit Muhammed Ikbali duke vizituar një ditë prej ditësh haxhilerët që ishin kthyer nga Medineja u drejton atyre këto pyetje të cilat ekspozojnë horizontin shpirtëror të një

besimtari të vërtetë:


“E vizituar Medinen e Përndritshme! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medines? Dhuratat materiale që keni sjellë, taket, tesbihët, sexhadet pas ca kohësh do të vjetërohen, do të vyshken dhe do të marrin fund. A na keni sjellë nga dhuratat e Medines që nuk fishken kurrë, që i japin jetë shpirtërove?”

A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit, drejtësi si të Umerit, ndjenjë turpi dhe bujari si të Uthmanit, klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut? A do të mund t’i falni botës Islame, që sot përpëlitet mes mijërave hallesh, emocionet e shekullit të lumturisë?”

O Zot, na dallo me vizitën e Haremeve fisnike! Na i prano adhurimet tona që i kryejmë gjatë haxhit dhe umresë!...

Amin!

Përktheu: **Ermal Nurja**



Virtytet që i fal zemrave besimtare një haxh dhe umre e pranuar janë të panumërta. Nuk mund të ketë përfitim siç duhet po qe se nuk e respektojmë edukatën ndaj haxhit dhe umresë dhe të kalohet kohë indiferente në ato vende të bekuara.



Biri im, të këshilloj për katër gjëra, dy prej të cilave mund t'i harrosh, por dy të tjerat kujtoji gjithmonë.

Një të mirë që u ke bërë të tjerëve harroje dhe të këqijat që të kanë bërë të tjerët harroji.

**Por Zotin (xh.sh.) mos e harro kurrë!
As vdekjen mos e harro!**

Biri im, mos u pendo pse heshte. Dije, nëse fjala është argjend, heshtja është flori.

Biri im, zgjidhi shokët të atillë që, kur të ndahesh prej tyre, as ti dhe as ata, mos të të marrin nëpër gojë!

shtrembëruar fytyrën ndaj tyre dhe mos ec duke u mbajtur më të madhe, se Allahu nuk i do njerëzit që mburren e lavdërohen.⁶

Të jesh i matur në ecjen tënde, të flasësh më zë të ulët, se zëri i lartë është zëri i gomarit.⁷

Këto ajete e mësojnë dhe e ushtrojnë besimtarin në delikatesë dhe modesti.

- Biri im, merr pjesë në vendin ku mësohet dituria dhe mundohu të mos largohesh nga ai vend.

- Biri im, të këshilloj për katër gjëra, dy prej të cilave mund t'i harrosh, por dy të tjerat kujtoji gjithmonë.

Një të mirë që u ke bërë të tjerëve harroje dhe të këqijat që të kanë bërë të tjerët harroji.

**Por Zotin (xh.sh.) mos e harro kurrë!
As vdekjen mos e harro!**

- Biri im, mos u pendo pse heshte. Dije, nëse fjala është argjend, heshtja është flori.

- Biri im, zgjidhi shokët të atillë që, kur të ndahesh prej tyre, as ti dhe as ata, mos

të të marrin nëpër gojë!

- Biri im, gjuhën mësoje vazhdimisht me tevbe dhe istigfarë duke thënë: "Allahummegfiri!" (O Zoti im, më fal mua). Sepse në çdo ditë është një orë, kur lutjet që bëhen, pranohen.⁸

- Biri im, nëse shkon në një vend ku janë mbledhur njerëz, përshëndeti përpara, jepu selam dhe mandej tërhiq në një qoshe. Pa folur ata, ti mos fol. Nëse e përkujtojnë Zotin (xh.sh.) merr pjesë me ta. Nëse zhyten në fjalë të kota, largohu nga ai vend.⁹

Në Kuranin famëllartë thuhet se shkakua që Zoti (xh.sh.) i kishte dhënë urtësi Llukman Hakimit ishte të qenit e tij falenderues ndaj Allahut (xh.sh.). Në ajetin kuranor thuhet: "Ne i patëm dhënë Llukmanit mençuri të përsosur dhe i thamë: "Të falenderosh Allahun, sepse e mira e atij falënderimi i takon atij."

Në të vërtetë, Allahu nuk ka nevojë për falenderimet tona, sepse Ai vetë është i madhërishtëm.¹⁰

Falënderimi është shprehja e gëzimit të robit ndaj dhuntive që i janë dhënë, është përgjigjja ndaj Zotit me fjalë, sjellje e veprime të ndryshme. Falënderimi është njohja e së mirës.

E lus Allahun e madhëruar të na bëjë prej falënderuesve dhe prej atyre që e përkujtojnë Atë.

O Zot, na mundëso që t'i këshillojmë njerëzit me urtësi dhe këshilla të mira, t'i heqim ato nga e keqja e t'i udhëzojmë në rrugën e drejtë.

Amin

1. Ibn Kethir, Bejrut, 1969, III, 443.

2. Bekare 2/269.

3. Tefsiri Ibn Kethirit, III, 443

4. Llukman, 16.

5. Llukman, 17.

6. Llukman, 18.

7. Llukman, 19.

8. Ahmet es-Savi, Tefsiri xhelalejn, Maas-Savi, III, 255.

9. Ibn Kethir, III, 447.

10. Llukman, 12.

Si ta respektojmë Kur'anin?

Një ditë isha ulur pranë derës së argjendtë në xhaminë e Profetit (a.s.) Para meje qëndronte ulur një i zi, etiopas. Fytyra e tij ishte e mbushur me aq dritë hyjnore nga besimi i ngrohtë saqë bukuria nuk mund t'i përfytyrohej. Duke qenë i qetë dhe entuziast herë pas here i shfletonte faqet e librit të shenjtë, Kur'anit. Kishte kaluar më se një orë që po lexonte. Isha kureshtar të dija se cilën sure po lexonte. Iu afrova pranë, por ç'të shihja faqet e librit i kishte kthyer në anë të kundërt, pra anën e poshtme të faqeve në të kundërt. U habita pa masë. Arrita në përfundimin se ai ishte një analfabet që tregonte interes më të madh se një studiues. Ky i zi etiopas në momentin që po shfletonte faqet e Kur'anit ndoshta mendonte mëshirën, mbretërinë e Zotit të gjithësisë dhe përfitonte më shumë sesa ai i cili mund ta lexonte tekstin. All-llahu alem, All-llahu e di më së miri.

Po ashtu atje ishte i pranishëm edhe siriani Abdullah efendiu. Ai tetë muajt e vitit i kaloi në Medinën e ndritur, ndërsa katër muajt e tjerë i kaloi në Siri. Gjatë qëndrimit të tij në Siri, kohën më të madhe e kalonte në mauzolen e shehut të madh Muhidin Arabiut. Edhe ky nuk dinte shkrim dhe lexim. Në kohën kur ishte në moshë të re i ka ndodhur një e papritur. Me t'u zgjuar nga gjumi e gjen veten e tij hafiz të Kur'anit. Duhet të ishte nga njerëzit me botë shpirtërore të madhe. Atij për shkak se Zoti i Madhërishtëm i dhuroi një mirësi të madhe shpirtërore, në shenjë falenderimi mbyllte një hatme në çdo dy ditë. Besimi i fortë e bënte atë mik me Zotin e Madhërishtëm. Po ashtu për aq kohë sa qëndronte në xhaminë e Profetit (a.s.) bënte maksimumin që t'i pastronte Kur'anët e kësaj xhamie, i puthte dhe i vendoste në raftet duke i radhitur

bukur. Ai i kishte vënë vetes detyrë që ta bënte këtë gjë gjatë kohës që ishte i pranishëm në xhaminë e profetit tonë të nderuar. Përkushtimi ndaj këtij shërbimi, ndjenja dhe dashuria e pastër që kishte nuk bëja dot pa e parë.

Këto që pashë ia tregova mjeshtrit tim shpirtëror. E kisha kuptuar që ishin të lumtur dhe kishin fytyra trëndafili e gëzimi, sepse për shkak të shërbimit që bënte kishte arritur të fitonte kënaqësinë e Perëndisë. Personat e cekur më sipër, në lidhje me respektin dhe edukimin që kishin ndaj Kur'anit Fisnik, bënë që ta fitonte kënaqësinë dhe Dashurinë e Allahut xh.sh. Profeti (a.s.) thotë: "Më i nderuari nga ju është ai i cili e mëson dhe ia mëson dikujt Kur'anin".

O njerëz! Dëshminë që keni ndaj Kur'anit paraqiteni duke i zbatuar urdhrat e tij. Kushtet e Besimit në numër janë pak dhe përbëhen nga fjali të shkurtra, ndërsa ato të veprave janë më shumë. Duhet ta besoni Kur'anin dhe t'i respektoni urdhrat, rregullat e tij. Fjalën e Zotit ta vërtetoni, pranoni, me zemrat tuaja plot. Me gjymtyrët tuaja bëni vepra nga më të mirat. Merruni me gjëra të rëndësishme që sjellin dobi në këtë jetë dhe në jetën tjetër, ahiret. Mosarritja e perceptimit dhe kuptimit të disa të vërtetave, për shkak të mendjeve tona të kufizuara, të mos bëhet shkak i mohimit të tyre.

Ebu'l-Mevahibi urdhëron e thotë: "E kam parë në ëndërr të Dërguarin e Allahut. Ai u drejtua nga unë me

këto fjalë:

-O Mevahib! Ç'është kjo gjendje, ç'është ky gjumë? Pse po e kthen shpinën? Çfarë të ka ngjarë që e ke lënë leximin e Kuranit? Të këshilloj që mos ta përsërisësh më këtë gjë. Nëse lexon pak Kuran, lexo, por vazhdimisht. Leximi, në asnjë ditë të mos jetë më i pakët se ai i një dite më parë".

Këtë libër të shenjtë dhe të vërtetë duhet ta lexojmë shkronjë për shkronjë, me qetësi, kënaqësi shpirtërore dhe me një dashuri të madhe. Është më e pëlqyer që të lexohet pak nga pak duke arrirë kënaqësinë shpirtërore, sesa të lexohet shumë, por pa arrirë kënaqësinë dhe pa i kushtuar kujdesin e duhur. Allahu i Madhëruar dhe i Shenjtë disa miqve të Tij ua ka bërë fatlume kohën. Disa e kanë kënduar të gjithë Kur'anin brenda një rekati, disa të tjerë brenda dy rekatëve. Këta evlia kanë qenë të përkushtuar gjatë leximit të tij dhe asnjëherë nuk kanë qenë të hutuar dhe të papërgatitur. Ata janë më afër Zotit të tyre. Asnjëherë nuk u ka munguar qetësia shpirtërore.

Kurani Fisnik tani gjendet në çdo shtëpi të muslimanit, por duhet të tregojmë respekt ndaj këtij libri të shenjtë. Duhet ta vendosim në vendin më të lartë në bibliotekat e shtëpive tona, duke e mbështjellë dhe e mirëmbajtur atë.

Përktheu: **Ali BARDHI**

MOS E SHIKO TE VOGEL, ASNJE TE MIRE



Takimi i një muslimani me vëllain e tij me buzëqeshje është një shenjë delikatese. Pejgamberi (a.s.) na nxit që çdo gjëje t'i afrohem me ëmbëlsi dhe të ndërtojmë marrëdhënie të shëndosha mes nesh, duke përdorur gjuhë të ëmbël dhe buzëqeshje.

Transmeton Muslimi se Ebu Dherri (r.a.) ka thënë: Pejgamberi (a.s.) më porositi mua duke më thënë:

“Në asnjë mënyrë mos të duken të vogla të mirat.”

E thënë ndryshe, sado që t'iu duket e vogël njerëzve një e mirë, ti në asnjë mënyrë mos e braktis atë, bëje. Çfarëdo e mirë qoftë ajo, mos thuaj “kjo është e vogël”, por bëje atë.

Qoftë kjo e mirë, edhe një buzëqeshje ndaj vëllait musliman.

“Mos e shiko të vogël asnjë të mirë qoftë edhe takimin e vëllait musliman me buzëqeshje, bëje atë.” (Muslim, Bir 144)

Pejgamberi (a.s.) me këto thënie sikur dëshiron të na thotë: “Mos i shikoni si të parëndësishme të mirat. Të paditurit sado që ta shohin si të parëndësishme, ti mos e nënvlerëso. Në të vërtetë ajo gjë është shumë me vlerë, shumë e rëndësishme, prandaj bëje... sepse edhe malet e mëdhenj përbëhen prej copave të vogla. Apo siç është shprehja e njohur, pika pika bëhet lumë... Ndoshta, me shkakun e atyre punëve të vogla, në ahiret të peshojnë më rëndë sevapet nga gjynahet dhe shkon në xhennet. Dhe ndoshta për shkak të mosvlerësimit të gjërave të vogla, në ahiret nuk gjen shumë punë të mira në peshoren tënde dhe për këtë shkak shkon në xhehennem bashkë me gjynahet tuaja... dhe për këtë gjë do të bëhesh shumë pishman. Mos e harro

kurrë ajetin Kur'anor që thotë: “**Dhe kush punon ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punon ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.**” (Zelzele.7-8) Pra, Allahu (xh.xh.) na e bën të ditur se në ditën e gjykimit do të jepet llogari edhe për gjërat më të vogla, qofshin të mira apo të këqija.

Pejgamberi (a.s.) në pjesën e dytë të hadithit jep një shembull shumë të bukur dhe na thërret që t'i buzëqeshim njëri-tjetrit. Takimi i një muslimani me vëllain e tij me buzëqeshje është një shenjë delikatese. Pejgamberi (a.s.) në këtë hadith na nxit që çdo gjëje t'i afrohem me ëmbëlsi dhe të ndërtojmë marrëdhënie të shëndosha mes nesh, duke përdorur gjuhë të ëmbël dhe buzëqeshje.

Me të vërtetë Islami i ka bërë një përmbledhje të mrekullueshme kuptimit të jetës. Një jetë plot të mira, me simpati dhe me buzëqeshje... Një musliman që i afrohet njerëzve dhe ambientit në përgjithësi, me buzën në gaz...

Sahabët kur tregonin për Pejgamberin (a.s.) thonin: “Ai, vazhdimisht na takonte me buzë në gaz. Kur buzëqeshte Ai, i bëhej fytyra si hëna katërmbëdhjetëshe...”

Jeta e Profetit (a.s.) është një burim i mbushur me buzëqeshje mëshironjëse. Nëse do të marrësh si shembull sunnetin e të dërguarit të Allahut (xh.xh.) do të fitosh një jetë plot harmoni dhe buzëqeshje, me të gjitha krijesat. Nëse këtë jetë mundohesh ta kalosh me buzë në gaz, me të gjitha krijesat për hir të Krijuesit të Gjithësisë, do të fitosh, inshaallah, gradën e buzëqeshjes dhe lumturisë edhe në botën tjetër. Allahu (xh.xh.) në Kur'anin famëlartë urdhëron e thotë: “**Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzueshme). Që Zotin e tyre e shikojnë...**” (Kijame, 22-23)

Paqja dhe mëshira e pafund e Allahut (xh.xh.) qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhammedin (a.s.), i cili na ka mësuar se buzëqeshja është sadaka, dhe gjithashtu na ka mësuar se si të arrijmë lumturinë, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

Përktheu: **ADEM PIZGA**



Atyre që jepen pas kësaj bote Profeti u drejtohet me fjalët: “Qofshin të mallkuar njerëzit e dhënë pas arit, argjendit, mëndafshit dhe luksit. Këtyre nëse u jepet ajo që u intereson, kënaqen. Nëse nuk u jepet ajo që duan, zemërohen dhe kundërshtojnë (ligjet e Allahut).”⁶

Njeriu është krijuar i tillë, që të ketë dëshirë për pasuri. Madje, nganjëherë, pasuria është ajo çfarë ai kërkon më tepër se çdo gjë tjetër.¹ Muhammedi (a.s.) ka thënë: “Zemra e të moshuarit mbetet e re në dëshirën për dy gjëra: pasuri dhe jetë.”² Gjithashtu Profeti i fundit ka treguar se dëshira e pa-kufi ndaj pasurisë mund të quhet mëkat prandaj duhet hequr dorë prej saj. Ai (a.s.) thotë: “I biri i Ademit po pati dy lugina me pasuri, kërkon të tretën. Ai nuk ngopet deri sa të vdesë. Allahu e pranon pendimin.”³ Në fakt, sipas fesë islame, mendimi i keq nuk quhet mëkat nëse nuk kthehet në vepër. Por nëpërmjet këtij hadithi tregohet që edhe pse lakmia e njeriut për një luginë të tretë me pasuri është vetëm dëshirë, nënkuptohet se është sprovuar më parë me pasurinë që i është dhënë, por në këtë provë, ai ka dalë “pa sukses...”. Prandaj lakmia jo vetëm nuk është e pëlqyeshme, por pranohet si mëkat. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Çdo ummet ka nje sprovë. Sprova e ummetit tim është pasuria.”⁴ dhe “Në ditën e kijametit njeriu nuk ka për të lëvizur nga vendi pa dhënë llogari për katër gjëra.”⁵ E një nga to është pasuria. Ai do të pyetet si e ka fituar dhe ç’ka bërë

Lugina e shkatërrimit

me të. Atyre që jepen pas kësaj bote Profeti u drejtohet me fjalët: “Qofshin të mallkuar njerëzit e dhënë pas arit, argjendit, mëndafshit dhe luksit. Këtyre nëse u jepet ajo që u intereson, kënaqen. Nëse nuk u jepet ajo që duan, zemërohen dhe kundërshtojnë (ligjet e Allahut).”⁶

Profeti (a.s.) e krahason pasurinë e kësaj bote me bimët e gjelbra.

Përfitojnë nga ajo vetëm ata që e marrin dhe ia dinë vlerën. Të tjerët, të uriturit e pangopur, nuk përfitojnë asgjë.⁷ Një ditë Ai (a.s.) po qëndronte mbi minber, ndërkohë i tha shokëve të tij: “Ajo që më frikëson më shumë për ju është pasuria dhe stolitë e kësaj bote që kanë për t’ua servirur.” Njëri nga shokët e pyeti: “O i dërguar i Allahut, diçka e hajrit a mund të sjellë diçka jo të mirë?” Profeti u tregoi se asnjëherë e mira nuk mund të sjellë të keqen, por mund të bëhet shkak për të, dhe tha: “Sa i vlefshëm është ai musliman që zotëron pasuri të kësaj bote dhe ua ndan të gjobëve, jetimëve dhe atyre që kanë ngelur rrugëve.”⁸ Në të gjithë këto hadithe nuk u fol për dëmin që sjell vetë pasuria, por për dëmin që sjell “etja për pasuri”. Në një tjetër hadith thuhet: “Dëmi që i sjellin dy ujë të uritur kopesë së deleve nuk është më i madh se dëmi që i sjellin fesë së një njeriu pasuria dhe luksi.”⁹

Pasuria është vlerësuar si stolia e kësaj bote dhe një nga gjërat me të cilat njeriu merret më shumë.¹⁰ Në Kur’an thuhet:

“O ju që besuat, as pasuria juaj e as fëmijët tuaj të mos u shmangin prej adhurimit ndaj Allahut. E kush bën ashtu, të tillët janë ata të humburit.” (Munafikun, 9)

Përderisa përmendet në ajetin kuranor, kjo tregon qartë se është shumë e vërtetë ajo që thamë më sipër. Pra fëmijët dhe pasuria nganjëherë zënë vend më shumë se asgjë tjetër në jetën e njeriut.

Njeriu, për shkak të lakmisë së tij, nuk është i kënaqur me pak, por do gjithmonë të ketë më tepër. Mundohet që fëmijët e tij të mos ia kenë nevojën askujt dhe të jetojnë sa më mirë.

Të fitosh pasuri nuk është e ndaluar, sepse Islami nuk e ndalon pasurinë dhe fëmijët, nëse nuk shkelen ligjet e tij. Ai ndalon të lihen pasdore adhurimet me qëllim për të fituar apo mbajtur mirë fëmijët.

Ndalon ruajtjen e pasurisë atëherë kur duhet dhënë.

Ndalon të menduarit "më pakësohet."

Besimtari duhet të punojë e të fitojë duke ditur se si të gjitha bukuritë e kësaj bote, edhe pasuria është kalimtare. E vetmja gjë që mbetet e përjetshme është vepra e mirë e bërë për hir të Allahut.¹¹

Kur lakmia pushton zemrën, largon njeriun nga adhurimet, po ashtu bëhet shkak që ai të mos ruhet nga gjërat e dyshimta e të kalojë deri tek të ndaluarat. Kështu pasuria dalngadalë bashkon të këqiat dhe zhduk të mirat.

Njeriu edhe pse ka ambicje nuk mund të marrë më tepër se i është caktuar...

Por ai vazhdon të shohë vetëm ambicjen e tij dhe s'njeh asnjë kufi. Kur ai e arrin atë që shpreson, i shtohet lakmia dhe dëshira për më tepër. Kur nuk e arrin atë që do, akuzon dhe fajëson veten për mundin e çuar bosh, humbet durimin dhe vrapon më shpejt pas asaj që ka humbur.¹²

Njeriu që jepet shumë pas pasurisë, që lufton për pushtet, që provon çdo rrugë për t'i arritur këto, dalëngadalë i humbet vlera e shpirtërores dhe moralit. Ky person mund të bëhet më i rrezikshëm se një


kafshë grabitqare, sepse kjo e fundit nuk vepron me mendje por me instikt. Njeriu, që i verbohen sytë nga kjo botë, që e sundon dashuria për të, humbet disa nga cilësitë njerëzore. Prandaj dijetarët islam dhe sufistët e njohur e kanë pranuar "lakminë për këtë botë" si burimin e të gjitha veseve të këqia.¹³ Ajo e largon njeriun nga realiteti, e shtyn drejt ëndrrave të parrealizueshme. Pastaj ai fillon të thur iluzione dhe harron botën tjetër. Ndërkohë çdo gjë që çon në harrimin e ahiretit është e papëlqyer. E gjithë kjo do të thotë se ambicja, lakmia dhe kërkesat e pafund janë një rrezik që mund të çojë në shkatërrimin e njeriut. Ky duhet t'u vërë kufi këtyre dhe të bëjë vepra të mira për këtë botë dhe për botën tjetër.

Meditimi mbi vdekjen të kujton ahiretin, zhduk lidhjen me këtë botë dhe e bën njeriun të bëjë gjithmonë vepra për të fituar kënaqësinë e Allahut. Mundësitë që ka i përdor aty dhe ashtu si duhet. Në këtë mënyrë kontrollon dashurinë ndaj kësaj bote dhe dëshirën për të jetuar gjatë e fituar pasuri.

Pra, besimtari nuk duhet të lidhet shumë me këtë botë dhe të shkatërrojë ndjeshmërinë e zemrës.

Besimtari i vërtetë duhet të jetë pronar i pasurisë dhe jo skllav i saj.

1. Nesai, Nikah 9.
2. Nesai, Nikah 9.
3. Buhari, Rikak 10.
4. Tirmidhi, Zuhd 26.
5. Tirmidhi, Kijamet 1.
6. Buhari, Xhihad 70.
7. Buhari, Zekat 50; Nesai, Zekat 50.
8. Buhari, Zekat 47.
9. Tirmidhi, Zuhd 43.
10. El-Kehf, 18/46.
11. En-Nahl, 16/96.
12. Maverdi, Edebu'd-dunja ve'd-din, fq. 222.
13. Çakan Kandemir, Rijadu's-salihin Tercume ve Serhi, fq. 156.



Njeriu që jepet shumë pas pasurisë, që lufton për pushtet, që provon çdo rrugë për t'i arritur këto, dalëngadalë i humbet vlera e shpirtërores dhe moralit. Ky person mund të bëhet më i rrezikshëm se një kafshë grabitqare, sepse kjo e fundit nuk vepron me mendje por me instikt. Njeriu, që i verbohen sytë nga kjo botë, që e sundon dashuria për të, humbet disa nga cilësitë njerëzore. Prandaj dijetarët islam dhe sufistët e njohur e kanë pranuar "lakminë për këtë botë" si burimin e të gjitha veseve të këqia.

GJUHA E DASHURISE DHE E MIRESISE

Profeti e shprehte kështu faktin se edhe besimi që është mirësia më e madhe është krijuar mbi bazat e dashurisë:

“Pa besuar s’mund të hyni në xhennet. Pa dashur njëri-tjetrit nuk mund të besoni...”

Gjuha e dashurisë dhe e mirësisë është një dhe e vetme. Atë e kupton çdokush.

Njerëzit edhe sikur të flasin në gjuhë të ndryshme ekziston një gjuhë e përbashkët që ta kuptojnë të gjithë. Kjo gjuhë është pikërisht “gjuha e dashurisë dhe e mirësisë”. Prandaj është thënë **“gjuha e dashurisë dhe e mirësisë është një e vetme. Atë e kupton çdokush”**. Me të vërtetë njerëzit si fëmijë, të rinj, të moshuar, burrë apo grua nuk kanë aspak vështirësi të kuptojnë dashurinë, mirësinë dhe dukuritë e tyre. Shpirti i njeriut afrohet dhe i përshtatet lehtësisht një shikimi plot dashuri dhe buzëqeshjeje, një sjelljeje tërheqëse që të ofron ndjenja sinqeriteti.

Dashuria dhe mirësia janë gjuha më ndikuese dhe e qëndrueshme e të kuptuarit për të ndikuar tek tjetri. Me thënien e një miku të ngushtë dashuria ka atë forcë për ta bindur tjetrit sa që në kohën tonë mund të krijojë ndikimin radiason. Si rrjedhojë gjuhën e dashurisë dhe të mirësisë e kupton me shumë lehtësi si ai që flet Turqisht ashtu edhe ai që flet Anglisht, Japonisht apo Rusisht. Bile edhe krijesat e tjera qofshin kafshë, bimë apo gjallesa

të tjera kuptojnë shumë mirë nga kjo gjuhë.

Padyshim që burimi i dashurisë dhe pika kulminante e të gjitha sjelljeve të bukura të lidhura me të është Pejgamberi (a.s.) që për ne mbetet shembulli i përkryer në çdo fushë.

Pejgamberi (a.s.) i cili i ka dhënë një rëndësi tepër të veçantë dashurisë dhe mirësisë bënte çdo gjë që të kishte mundësi për t’i fituar zemrën tjetrit dhe për ta bërë atë të lumtur pa marrë parasysh asnjë post apo famë. Ai tregonte një kujdes tepër të veçantë që të mos t’ua thyente zemrën njerëzve. Ai është krijuar gati-gati për t’i kënaqur njerëzit me përjashtim të kundërshtimit të urdhërave të Zotit. Jeta e Tij është krijuar mbi principin për t’i bërë për vete njerëzit dhe jo për t’i humbur ato. Ai na mësoi se s’mund të jetë e mundur të fitohen njerëzit pa iu afruar atyre me dashuri dhe pa u fituar zemrat.

Kështu e shprehte ai faktin se edhe besimi që është mirësia më e madhe është krijuar mbi bazat e dashurisë:

“Pa besuar s’mund të hyni në xhennet. Pa dashur njëri-tjetrit nuk mund të besoni...” (Muslim, Iman, 93)

Në mënyrë të veçantë ai bënte

çdo gjë që ishte e nevojshme që t’i hiqte farat e urretjes që zhdukën dashurinë mes njerëzve dhe të siguronte paqen dhe qetësinë mes tyre. Tregues i kësaj përpikmërie është me shumë domethënie edhe ngjarja:

Një ditë Pejgamberit (a.s.) i erdhi një bedevi (endacak) për t’i kërkuar ndihmë. Pejgamberi (a.s.) pasi i dha nga ato që kishte pranë e pyeti:

- A të kënaqin këto? Bedeviu me një etikë të dobët i tha:

- Jo! Nuk më ke dhënë mjaftueshëm!

Pas kësaj që ndodhi disa sahabë që ndodheshin aty iu nxeën bedeviu dhe kërkuan t’i tregonin kufijtë e reagimit, kurse Pejgamberi (a.s.) duke i paralajmëruar u tha që mos ta preknin. Pas kësaj e mori me vete dhe e drejtoi për në shtëpi. Pasi i dha diçka nga shtëpia e pyeti:

- Tani a tu plotësua dëshira? Bedeviu këtë herë i lumtur tha:

- Po! Allahu të dhëntë shumë mirësi nga llogaria e familjes dhe e të afërmeve të mi!

Kështu Pejgamberi (a.s.) i cili ia fitoi zemrën dhe e kënaqi atë me qëllim që të largonte atë ftohtësi që doli në dukje mes sahabëve dhe bedeviu tha:

“Ti në fillim the ato që the

duke i vlerësuar si të pakta ato që të dhamë. Për këtë arsye në zemrat e shokëve të mi mund të jetë vënë në dukje një urrejtje ndaj teje. Kur të kthehesh tek ata përsëriti të njëjtat fjalë që më the mua tani në mënyrë që atyre tu largohet urrejtja që kanë ndaj teje! Menjëherë sapo bedeviu e pranoi këtë propozim shkuan pranë sahabëve. Bedeviu duke iu kthyer Pejgamberit (a.s.) u lut duke thënë:

“Allahu të dhëntë mirësi të shumta nga llogaria e familjes sime dhe të afërmve të mi” dhe më pas u largua që andej.

Pasi bedeviu u largua Pejgamberi (a.s.) u kthye nga sahabët u tha:

“Gjendja e këtij bedeviu me mua i ngjason gjendjes së personit i cili ka një deve, por ajo ka ikur, ndërsa populli i shkon nga pas për ta kapur, por deveja e trembur për shkak të këtij tubimi trëmbet shumë dhe vrapon akoma edhe më tepër për t’i ikur turmës. Më pas i zoti i devesë i drejtohet popullit duke i thënë: “Largohuni prej meje dhe devesë. Unë sillem më mirë ndaj saj, unë e di më mirë se ju se ç’huqe ka ajo” dhe ikën i vetëm pas devesë. E thërret devenë duke marrë nga hurmat e rëna në tokë dhe deveja vjen. Burri kap devenë, hipën në të dhe largohet. Edhe unë sikurse ky rast të kisha dëgjuar fjalët e bedeviu të thëna në atë çast i shkreti kishte për të shkuar në xhehennem” (Mervezi, Tadhimu gadri’s-salat, II, 931; Hejthemi, Mexhmau’z-zevaid, IX, 160)

Siç kuptohet edhe nga ky shembull, Hz. Pejgamberi nuk ka preferuar asnjëherë të jetë i ashpër përballë sjelljeve të rënda të drejtuara Atij personalisht, përkundrazi ka parapëlqyer të jetë me natyrë trëndafili (i urtë, i

qeshur etj.) Me këtë natyrë ai është bërë shkak i shërimit të zemrave të thyera dhe shpirtëve të sëmurë si dhe i udhëzimit të njerëzimit pasi ai e dinte shumë mirë se ç’do të thoshte plagë shpirtërore dhe se çfarë do t’u dhuronte njerëzve lidhja dhe njohja mes tyre.

Sa bukur e pasqyron kjo ngjarje faktin që plaga shpirtërore nuk mund të përmirësohet lehtësisht. Sado të përmirësohen zemrat e thyera përsëri mbeten gjurmë në të dhe prandaj është e domosdoshme që të jemi të kujdesshëm që të mos i lëndojmë zemrat që janë syri hyjnor.

Një herë e një kohë ka qenë një djalos me karakter të keq. Babai i tij për t’ia hequr këtë zakon të dobët gjeti një formulë të tillë. Një ditë babai i dha një çantë me gozhdë dhe një dërrasë. Dhe i tha:

- Sa herë të debatosh, të grindesh me shokët apo t’ua thyesh zemrat, ngul një gozhdë në dërrasë.

Djaloshi i ri që në ditën e parë nguli në dërrasë 37 gozhdë. Pas një periudhe kohe, pasi e kishte kuptuar se ku e kishte patur qëllimin i ati dhe për të vërtetuar se nuk ishte edhe aq i keq, në javët

në vazhdim filloi ta kontrollonte veten duke u përpjekur që të ngulte sa më pak gozhdë. Erdhi një ditë ku në dërrasë nuk kishte ngulur asnjë gozhdë. I gëzuar shkoi tek i ati për ta lajmëruar për ti dhënë lajmin e gëzuar.

- Të dy shkuan ta shihnin nga afër dërrasën dhe kur mbërritën tek vendi babai i tha: - Të lumtë biri im! Tani duke filluar që sot çdo ditë sa herë që të mos grindesh me shokët heq një gozhdë.

Kaluan ditë, dhe djaloshi hoqi të gjitha gozhdat. Babai i gëzuar u shpreh:

- Të lumtë biri im! Je sjellur shumë mirë. Tani shiko me shumë kujdes këtë dërrasë. Tashmë në të ka shumë vrima apo jo? Prandaj ajo nuk do të duket më e bukur si më parë. Biri im! Ja pra, si kjo gjendje kur debaton dhe grindesh me shokët thuhet fjalë të këqija çdo fjalë e keqe lë një gjurmë në shpirtin e njeriut. Shokut mund ti bësh një mijë të mira, mund ti thuash që e ke falur, por kjo plagë (vrimë) e hapur mbetet përherë e njëjtë dhe nuk mbyllet.



MENDJA, VLERA DHE KUFIJTË E SAJ

Mendja është dhurata që Zoti i Madhëruar ka vendosur në fitratin (natyrën) e njeriut dhe të logjikuarit nuk bie në kundërshtim me parimet fetare, por arsyetimet e shëndosha ndihmojnë për ta forcuar besimin dhe për ta bërë të palëkundshëm. Të mbrosh idenë se nuk i duhet besuar logjikës jo vetëm që tregon informimin e gabuar apo të mangët rreth qëndrimit që ka feja Islame, kryesisht Kur'ani, ndaj arsyes, por edhe i bie ndesh natyrës njerëzore.

“...Zoti i poshtëron ata që nuk mendojnë!”
(Kur’ani, Junus, 100)

Në kohët e sotme, shumë njerëz i shohin fenë dhe mendjen si dy pole të kundërta. Një pjesë e tyre e konsiderojnë mendjen si kriter të palëkundshëm, kurse një pjesë tjetër e vlerësojnë interpretimin tradicional fetar si burim të vetëm.

Duhet përgëzuar të krishterët, nëse me të vërtetë kanë mundur t’i vënë në një bazament logjik parimet e tyre fetare, të cilat i kanë të bazuara në mrekullira, në një zot antropomorfik, në mëkatën origjinal, trinitetin dhe në teori të tjera që të bëjnë me të vërtetë të mendosh se “vërtetë, mund të ketë njerëz që besojnë në këto gjëra?!”

Ndërsa, në besimin islam të logjikuarit në çështjet fetare është një pjesë e shpjegimit që i bëhet fesë. Këtë e vërejmë edhe tek mënyra e të shprehurit e Profetit, i cili përherë bënte sqarime bindëse me shembuj të shumtë, sipas shkallës së intelektit që kishte dëgjuesi. (Për metodat logjike në komunikimin me njerëzit që ka bërë Profeti Muhammed shih. Ali Yardım, Hadis I-II, Shtëpia Botuese Damla, Bot. III, Istanbul 1997, f. 100-106) Gjithashtu, edhe pas tij, dijetarët nuk kanë bërë ndonjë ndarje mes të arsyetuarit dhe të besuarit. Mirëpo, me sa duket, pasi u vu re se po abuzohej me të logjikuarin, duke futur brenda parametrave të mendjes dhe duke konkretizuar çdo gjë, madje edhe Zotin, pra me lëvizjet e para të rrymës Xhismijje (Fraksioni që disa versete muteshabih/figurativ siç janë Fet’h, 10; Araf, 54, etj. i komenton duke ngjasuar cilësitë e Zotit me të njeriut), rryma që pranon një Zot antropomorfik. Ky grup ndryshe quhet edhe “Muxhessime” edhe “Kerramije”. (Suleyman H.Bolay, Felsefesi Doktrinler ve Terimler Sozlugu, Shtëpia Botuese Akçag,

Bot.VIII, Istanbul 1999, f. 68-69) Dijetarët e kohës filluan të bëjnë ndarjen mes besimit dhe logjikës. Por disa prej tyre kultivuan një urrejtje të çuditshme ndaj mendjes, aq sa logjikën e konsideruan si armik, diçka të poshtër, të pavlerë, një rrugë që të drejton për në xhehennem, e krahasuan me shejtanin, etj. E bënë aq alarmante këtë, sa që mbrojtën me fanatizëm idenë se nuk duhej komentuar asgjë me karakter fetar. Kështu, me dashje apo pa padashje, u bënë nismëtarët e dogmatizmit në fenë islame.

Kurse Kur’ani, si përherë u jep njerëzve horizont të gjërë. Fjalën e parë të Tij Allahu e ka filluar duke na urdhëruar të lexojmë e studiojmë (Alak, 1), që tregon se vetëm duke përdorur mendjen, mund të dallohemi nga krijesat e tjera. Zoti na nxit të vëmë në punë këtë veti që na e ka dhuruar vetëm ne, duke na parashtruar në ajete të shumta versione të ndryshme të fjalisë “..pse nuk mendoni?” Në Kur’an në 14 vende kalon shprehja “pse nuk mendoni?”, në 8 vende “që ju të mendoni”, në 9 vende “për një popull që mendon” dhe në mbi 100 vende kalon fjala “mendje e llogjikë”..

Le t’i hedhim një sy verseteve më poshtë që tregojnë se çfarë thotë Allahu për ata që nuk e përdorin logjikën:

“Krijesat më të dëmshme te Allahu janë ata të shurdhëtit (që nuk dëgjojnë të vërtetën), memecët (që nuk thonë të drejtën) dhe ata që nuk logjikojnë.” (Enfal, 22)

“Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë, pos me ndihmën e Allahut. (Zoti) i poshtëron ata

që nuk mendojnë.” (Junus, 100)

“Dhe thonë: “Sikur të kishim dëgjuar (Profetin), ose të kishim logjikuar, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit”. (Mulk, 10). Lidhësja “ev” që do të thotë “ose, apo”, që kalon në këtë verset tregon qartë se si bindja ndaj vahjit (revelacionit) ashtu edhe të logjikuarit njeriun e shmang nga xhehennemi.

Dy ajetet e fundit më sipër na tregojnë haptazi se të besuarit dhe të menduarit kanë lidhje me njëri-tjetrin, nuk janë në kundërshtim, madje të logjikuarit ndihmon në besimin e vërtetë. Këtë të vërtetë janë munduar ta përkrahin plot mendimtarë, dijetarë dhe udhëheqës të metodologjive të ndryshme, si Maverdi, Ibn Rushdi, Ibn Tejmijje.

Ibn Tejmijje ka një vepër volumoze me titull “Der’u te’arudi’l-Akli ve’n-Nakli” që e ka shkruar për të mbrojtur idenë se Akli dhe Nakli (mendja dhe burimi fetar) nuk bien në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Shkurtimisht, duhet theksuar se mendja është dhurata që Zoti i Madhëruar ka vendosur në fitratin (natyrën) e njeriut dhe të logjikuarit nuk bie në kundërshtim me parimet fetare, por arsytimet e shëndosha ndihmojnë për ta forcuar besimin dhe për ta bërë të palëkundshëm. Të mbrosh idenë se nuk i duhet besuar logjikës jo vetëm që tregon informimin e gabuar apo të mangët rreth qëndrimit që ka feja Islame, kryesisht Kur’ani, ndaj arsyes, por edhe i bie ndesh natyrës njerëzore. Pra, përmbledhtazi kjo do të thotë që njeriu të zgjedhë të mos ketë dallim prej krijesave të tjera.

2. KUFIJTË E MENDJES

Siç e cekëm dhe më lart, mendja është dhurata më e çmuar që na është dhënë. Prandaj, njeriu përballë çdo situatë mundohet të gjejë dimensionin e arsyeshëm të

ngjarjeve. Njeriu, ngaqë është mësuar, ka nevojë t’i gjykojë gjërat nga aspekti shkak-pasojë, sepse e di që çdo gjë në botë është krijuar nga një shkak; nëse bie diçka, e ka pasur një shkak për të rënë; nëse diçka lëviz, ka qenë një arsye që e ka bërë të lëvizë. Njeriu e ka të vështirë të perceptojë diçka të pavarur nga fenomeni kohë, të pranojë ekzistencën e gjërave të paformë apo të pangjyrë, aq më tepër diçka që nuk mund ta shohë. Pra, njeriu është i prirur të pranojë



Në Kur’an në 14 vende kalon shprehja “pse nuk mendoni?”, në 8 vende “që ju të mendoni”, në 9 vende “për një popull që mendon” dhe në mbi 100 vende kalon fjala “mendje e llogjikë”

si të vërteta të vetme vetëm ato gjëra që ia perceptojnë shqisat e tij dhe çdo gjë që e rrethon, e komenton nga këndvështrimi që ka krijuar me shqisat e veta. Porse, nganjëherë me këtë “program” njeriu mund të bjerë në një pozicion qesharak, ashtu si tregohet në këtë anekdotë të shkurtër:

Kohë më parë, kur radiot sapa kishin dalë në treg, një fshatar bleu një radio dhe e mori me vete në fshat. Bashkëfshatarët, normalisht nuk ia kishin haberin se ç’ ishte.

Kur ndezi radion, ata u habiten se si mund të fliste diçka pa pasur gojë e gjuhë dhe u përpoqën të gjejnë se ku mund ta kishte gojën, ngaqë ashtu ishin mësuar. Sipas tyre çdo gjë që fliste duhej të kishte gojë...

Njeriut i janë dhënë disa shqisa dhe ai gjithmonë mundohet të përdorë mendjen sipas tyre, duke u përpjekur të perceptojë çdo gjë që e rrethon, çdo gjë që dëgjon apo që lexon. Po mirë, vallë a ka ndonjë fushë ku mendja nuk mund të funksionojë si duhet? Normalisht që po. Janë disa pika ku dilet jashtë mundësive të mendjes. Disa nga këto pika për të cilat Zoti nuk na ka dhënë shqisa që t’i perceptojmë si duhet, janë:

1. Forma e Krijuesit dhe krijesave që tregohen nëpër tekstet fetare, të cilat janë jashtë fuqisë dhe optikës sonë. Ngaqë ne jemi krijuar me një formë, mendojmë se çdo gjë duhet të jetë e formësuar. Ashtu siç e trajton edhe Ibn Tufejl (Ibn Tufejl (1106-1185) ishte një filozof iluminist (ishraki) mysliman me origjinë nga Andaluzia, i cili ashtu sikur Ibn Sinai (Avicena), u mundua të paraqesë një botëkuptim të ri duke gërshtëuar urtësinë e Orientit me diturinë e Greqisë. De Boer, Islam Felsefe Tarihi, f. 229; H. Ziya Ülken, Islam Dusuncesi, f. 320; Necip Taylan, Anahtarlarıyla Islam Felsefesi, f. 238) në librin e tij “Hajj Ibn Jakdhan” (Hajj Ibn Jakdhan (I gjalli biri i të zgjuarit) është tregimi filozofik i Ibn Tufejlit. Gjurmët e këtij libri duken qartë në librin “Kritika” e Baltazar Grasyan-it, në “Atlantikun e ri” të Francis Bacon-it, në “Robinson Cruseo” të Daniel Defoe, në “Xhunglën” dhe “Pyllin” e Rudyard Kipling. M.Riza Hakimi, Islam Bilim Tarihi, f.212), një mendje e shëndoshë mund të arsyetojë gjer në mundësinë e ekzistencës së Zotit, në cilësitë e Tij (dituri absolute, kontroll i përsosur) dhe në madhësinë e Tij, por, nëse kërkohet që patjetër Ai të ketë një formë, kjo është metodë e gabuar, ngase formë kanë vetëm gjërat që janë materie dhe materiet janë vetëm të kufizuara. Përderisa Zoti

nuk është objekt dhe nuk është i kufizuar, atëherë përpjekjet e njeriut për një gjë të tillë, janë absurde.

2. Pafillimësia dhe pafundësia. Kur thuhet se “Zoti është i pafillimtë, i pafund”, a e kuptojmë për çfarë po bëhet fjalë? Po kur themi se në botën tjetër njeriu do të jetë deri në pafundësi në xhennet apo në xhehennem? E kemi kuptuar ne se ç’do të thotë të jesh i pavdekshëm? Njeriu është brenda fenomenit kohë, është i krijuar bashkë me të dhe për njeriun duket si e pamundur (ose duket shumë e vështirë) të perceptojë gjërat që janë jashtë kohës, siç është Zoti për shembull, ngase vetë Ai e ka krijuar kohën dhe është më se absurde të kërkohet mjeshtri, brenda produktit të vet. Ne kemi të programuar në mendje çdo gjë me fund; diçka lind, rritet dhe pas një kohe të caktuar vdes, apo çdo gjë që fillon, përfundon. Është e pakapshme për logjikën të qenurit “jo i lindur” dhe “i pavdekshëm” apo “i pafillimtë” dhe “i pafund”. Kur të kuptojmë se çfarë është “koha” në të vërtetë, atëherë do e kuptojmë më mirë se ç’do të thonë konceptet që janë jashtë saj (Për informacion të detajuar rreth fenomenit “kohë”, shih Harun Jahja, “Esenca e Vërtetë e Lëndës” Kapitulli i kohës.)

3. Hapësira dhe vendi. Pyetja “Ku ndodhet Zoti?” tregon qartë se njeriu ka nevojë të perceptojë çdo gjë me veglat që është pajisur. Mirëpo, duhet të dimë se hapësira/vendi është e lidhur me objektin. Aty ku nuk ka objekt, nuk ka as hapësirë/vend. Shprehjet “majtas, djathtas, poshtë, lart” marrin kuptim vetëm kur përdoren për një objekt. Përdërisa nuk mund të flasim për Zotin si objekt, nuk mund të flasim edhe për vendin e Tij. (Për informacion më të gjërë rreth

“vendit” të Zotit, shih. “Ku ndodhet Zoti”, Drita Islame, Viti XV i Bot, Nr. 6, Tetor 2005)

4. Gjërat që i përkasin pas vdekjes. Ngaqë bëhet fjalë për parametra të tjerë, mendja mund të arsyetojë mundësinë e të qenurit të një bote tjetër deri në vlerat e asaj bote, por pastaj, siç kanë bërë shumë filozofë si Farabiu, Ibn Sinai, Gazali, gjithashtu dhe Jack Maritain, etj.. (shih Mehmet S.Aydin, Din Felsefesi, Shtëpia Botuese Izmir Ilahiyat Vakfı, Bot. X, Izmir 2002, f. 235-244)



Në besimin islam të logjikuarit në çështjet fetare është një pjesë e shpjegimit që i bëhet fesë. Këtë e vërejmë edhe tek mënyra e të shprehurit e Profetit, i cili përherë bënte sqarime bindëse me shembuj të shumtë, sipas shkallës së intelektit që kishte dëgjuesi.

Njeriu detyrohet t’i dorëzohet teksteve fetare. Kjo është njësoj sikur një peshoreje që mundet të peshojë deri në 20 ton t’i ngarkohet një peshë më e madhe. Shigjeta e peshores do të arrinte deri në maksimumin e saj, por nuk mund të jepte ndonjë të dhënë tjetër, aq më pak nuk do mundej të tregonte peshën.


Gjithashtu duhet besuar se çdo gjë që na thuhet në tekstet autentike Islame, nuk është jashtë aftësisë

së mendjes, sepse vahji/revelacioni është dërguar qartë, që të kuptohet, e jo i pakuptueshëm, që të mbetet i paarrtshëm për njeriun. Madje, revelacioni është futur në atë formë që njeriu ta kuptojë sa më lehtë fjalën e Zotit. Nëse aktualisht kemi diçka të paqartë nga Kur’ani, kjo tregon se nuk kemi metodë të rregullt në të arsyetuar dhe po ta gjejmë atë metodë, atëherë ai do të bëhet i kuptueshëm. Si shembuj mund të marrim ajetet që ishin të paqarta për popujt e mëparshëm, për të cilat mundoheshin të jepnin shpjegime sipas imagjinatës së tyre. Mirëpo, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e shkencës këto ajete filluan të kuptoheshin. Fjala vjen, mjafton t’i hidhet një sy komenteve klasike të Kur’anit që janë bërë rreth “dy deteve” (Furkan, 53; Neml, 61; Rahman, 19; Fatir, 12), do të kuptohet se sado që janë përpjekur ta komentojnë se ç’mund të ishin këto “dy dete”, në mendjen e njerëzve mund të kenë lënë bindje jo të plotë, derisa në shekullin 20-të u vërtetua shkencërisht se bëhet fjalë për dy dete që nuk bashkoheshin. Kjo tregon universalizmin e Kur’anit dhe vërtetësinë e fesë Islame.

Artur Tagani

Zv/drejtor në shkollën
“Haxhi Sheh Shamia”,
Shkodër

PERSONALITETI I THIRRRESIT ISLAM



Thirrësi islam thërret për tek Allahu, në rrugën e Tij, thërret për shpëtim në të dy botët; triumfues e të lumtur në këtë botë, dhe shpëtimtarë e shumë të shpërblyer në botën tjetër. Ai fton në Xhennet, dhe largon nga Xhehennemi. Ai fton për të mira dhe na largon nga të këqijat duke na tërhequr vërejtjen për to. Ai është shpjegues i fjalëve të Allahut dhe sqarues i mësimëve të Tij. Ai është e kundërta e tagutit dhe e shejtanit.

pastaj u morën dijetarët si trashëgimtarë të pejgamberëve, njerëzit e mirë e të dalluar, falë të cilëve Thirrja

dhe largon nga Xhehennemi. Ai fton për të mira dhe na largon nga të këqijat duke na tërhequr vërejtjen për to. Ai është shpjegues i fjalëve të Allahut dhe sqarues i mësimëve të Tij. Ai është e kundërta e tagutit dhe e shejtanit. Ai është edukator i brezit të ri. Feja nuk do të dëmtohej shumë nëse ka kreatorë të dobët, vetëm njerëzit do të visheshin dobët. Mirëpo, nëse thirrësi islamë nuk do të ishin në nivelin e detyrës dhe përgjegjësisë, atëherë do të formonin brezin e të paditurve, imituesve, labilëve... të cilët do të shkatërronin ardhmërinë e fesë. Së këndejmi kuptojmë se misioni i thirrësit islam është shumë delikat dhe ka përgjegjësi të madhe, sepse prej tij varet shumëçka.

Interesimet gjithnjë e më të mëdha për këtë problematikë, ndikuan që së voni të formohet një disiplinë e re shkencore për studimin e Thirrjes Islame dhe përgatitjen e kuadrove, thirrës islamë.

S'ka dyshim se formimi i kësaj discipline hapi rrugën për një studim më të hollësishtë në këtë fushë, sepse kontributi që mund të japë thirrësi islam, nuk mund

Si në të kaluarën, ashtu edhe sot e nesër, personaliteti i thirrësit islam ka qenë, është e do të jetë përherë njëra nga shëmbëlltyrat më të ndritura të historisë islame, sepse prej tij varet ardhmëria e fesë islame. Personaliteti i thirrësit islam, qoftë në kuptimin e gjerë të fjalës si thirrës islam që nga koha e Ademit (a.s.), qoftë në kuptim të ngushtë, nga Muhammedi (a.s.) e këndej, ka ngjallur interesim të vazhdueshëm dhe ka luajtur rol me rëndësi në përhapjen e fjalës së Allahut (xh.sh.). Qysh prej njeriut të parë, Ademit (a.s.), me këtë mision të shenjtë u morën individët më të shquar e më të respektuar të shoqërisë, ata që u shquan për devotshmëri, moral e sjellje të mira. U morën pejgamberët e Zotit si nismëtarë të këtij misioni, dhe ata padyshim janë njerëzit më të zgjedhur e më të mirë, u morën pastaj shokët e pejgamberëve, gjenerata më e mirë pas tyre,

Islame u shpërndanë në të katër anët e botës.

Personalitetin dhe rolin e thirrësit islam e ka ngritur lart për të mos rënë kurrë edhe Kurani, madje në shumë vende:

“A ka fjalë më të bukur se ai që thërret tek Allahu, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë, jam prej muslimanëve”.

(Fussilet, 33)

Ndërsa Pejgamberi (a.s.) thotë:

“Që ta drejtojë Allahu një njeri përmes teje, është më mirë se dynjaja dhe gjithçka ka në të”.

Së këndejmi, del se cilësitë e personalitetit të thirrësit islam janë fisnikëria e ndershmëria. Askush tjetër nuk mund të krahasohet me të për nga këto cilësi. Ai është mik dhe i dashuri i Allahut.

Thirrësi islam thërret për tek Allahu, në rrugën e Tij, thërret për shpëtim në të dy botët; triumfues e të lumtur në këtë botë, dhe shpëtimtarë e shumë të shpërblyer në botën tjetër. Ai fton në Xhennet,

të zëvendësohet me asgjë. Ai është hallkë lidhëse ndërmjet së kaluarës dhe së ardhmes, ndërsa, në anën tjetër, ai, duke e njohur këtë materie, u shmanget gabimeve të mundshme gjatë kryerjes së misionit të tij. Prandaj, nuk është aspak e habitshme që shumë shoqata, sekte e drejtime të ndryshme të harxhojnë shuma marramendëse për përgatitjen e misionarëve të rinj dhe për shpërndarjen e tyre. Pë këtë arsye edhe ne duhet t'i kushtojmë kujdes të madh përgatitjes së kuadrove, sepse, ndonëse brumi (Kur'ani dhe Synneti) është jashtëzakonisht i mirë, gatuesit e tij, fatkeqësisht, shpeshherë nuk janë në nivel.

Zhvillimi gjithnjë e më i hovshëm i teknikës dhe i teknologjisë bashkëkohore ka ndikuar që jo rrallë të dëgjohen ca zëra, që përpiqen ta zbehin rolin dhe personalitetin e thirrësit islam, madje shpeshherë dhe e mohojnë atë. Natyrisht, askujt nuk i ndalohet që të thërrasë në fenë islame dhe të flasë për të, sepse të gjithë myslimanët janë të obliguar për ta bërë një gjë të tillë, por fjalën përfundimtare e thonë njerëzit kompetentë. Nuk mjafton të njohësh një gjuhë të huaj dhe të përkthesh një libër për të

pretenduar se je njohës i mirë i fesë islame, apo nuk mjafton të lexosh një libër për tu bërë hoxhë (thirrës islam). Duke mos mbajtur parasysh këtë, sot në Kosovë janë botuar shumë libra, të cilët në vend që të sjellin dobi, kanë dhënë kundërefekt me pasoja jo të vogla dhe janë bërë "mollë shëri" duke shtënë huti e dyshime në mesin e besimtarëve, ndërsa thirrësve islamë u kanë sjellë mjaft kokëçarje. Ekziston një ligj i pashkruar, i cili thotë se nuk mjafton të njohësh një gjuhë e të përkthesh diçka nga ajo, por, duhet ta njohësh edhe materien që përkthen. Dihet se kush është kompetent dhe përgjegjës për botimin e librave me tematikë islame.

Thirrësi islam, para se të nisët për misionin e tij bujar, duhet të njohë hollësisht dhe në detaje temperamentin, mentalitetin, gjuhën, kulturën, traditën e atyre që do t'i thërrasë në Islam. Ai duhet të ketë përgatitje solide për atë vend, njësoj si një emisar politik, kuptohet, nëse synon suksesin. Nëse një gjë e tillë nuk kihet parasysh, atëherë misioni do të pësojë një fiasko të vërtetë. Kështu, një arab, një pakistanez apo një iranian i ardhur në vendin

tonë, mund të jetë thirrës islam shumë i zgjuar, por jo edhe i suksesshëm. Ai, madje që në fillim, është i destinuar për të dështuar.

As aplikimi i teknologjisë moderne nuk mund ta mënjanojë thirrësin islam. Ajo madje nuk mund të jetë e suksesshme pa pjesëmarrjen dhe pa një varg tiparësh praktike, etike e pedagogjiko-psikologjike të tij. Thënë shkurt, makina nuk mund ta zëvendësojë thirrësin islam dhe nuk mund ta luajë rolin e tij në mesin e njerëzve, por padyshim ajo mund ta ndihmojë shumë atë.

Në sajë të këtij vështrimi të shkurtër, mund të arrijmë lehtë në përfundimin se ka qenë, është e do të jetë faktor i pazëvendësueshëm, siç janë ajri dhe drita e diellit.

Arritja e qëllimit të dëshiruar në marrjen e mësimave të fesë varet plotësisht nga vlera e thirrësve të saj. Aq sa vlejnë thirrësit e fesë islame, po aq do të arrihet në qëllimin e dëshiruar për mësimin e fesë.

A mund të bëhet hije e drejtë nëse shkopi është i shtrembër?

Thirrësi islam, para se të nisët për misionin e tij bujar, duhet të njohë hollësisht dhe në detaje t e m p e r a m e n t i n , mentalitetin, gjuhën, kulturën, traditën e atyre që do t'i thërrasë në Islam. Ai duhet të ketë përgatitje solide për atë vend, njësoj si një emisar politik, kuptohet, nëse synon suksesin.



"Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin" Libër që dhuron emocion dhe ngjall nostalgji...

Këshilla dhe udhëzime ndryshe nga shumë këshilla e udhëzime, me të cilat lexuesi mund të ndeshet gjithandej nëpër libra të kësaj familjeje. Arsyeja është se autorin e këtij libri e karakterizon një botë e madhe plot mistikë të pastër që rrjedh nga burimet e Islamit dhe një thellësi në të menduarit për besimin dhe udhëzimet e tij.


"Që punët të jenë të mira, duhen plotësuar dy kushte:

1. Tadhim li-emril-lah, zbatimi i rregullt i urdhrit hyjnor.

2. Shefkat li-halkil-lah, dhembshuri për krijesat e Zotit."
(Osman Nuri Topbash: "Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin", fq.60)

Duke lexuar librin e autorit të mirënjohur Osman Nuri Topbash: "Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin", lexuesi, dashje pa dashje, do të gjejë një hapësirë të gjerë plot me këshilla dhe udhëzime, të përziera me dritën e mësimëve kur'anore, profetike dhe atyre të dijetarëve të shpirtit e reflektimeve të pastra të dashurisë... Janë këshilla dhe udhëzime ndryshe nga shumë këshilla e udhëzime, me të cilat lexuesi mund të ndeshet gjithandej nëpër libra të kësaj familjeje. Arsyeja është se autorin e këtij libri e karakterizon një botë e madhe plot mistikë të pastër që rrjedh nga burimet e Islamit dhe një thellësi në të menduarit për besimin dhe udhëzimet e tij.

Kështu, që në parathënien e librit, autori citon: "Meqë Zoti e ka krijuar qenien me dashuri, i ka falur asaj një enigmë krejt të veçantë. Për rrjedhojë, aty ku s'ka dashuri, shihen shfaqje perëndimi e humbjeje, kurse aty ku ka dashuri, shihen shfaqje përsosmërie." (Po aty, fq.5) Në këtë mënyrë ai tërheq vëmendjen drejt dashurisë që Krijuesi i ka dhuruar



krijesave të Tij e njeriut në veçanti, si një mjet udhëzimi drejt dritave ushqyese të zemrës dhe inspiruese të mendjes, në rrugën e gjatë të jetës, për të cilat njeriu ka shumë nevojë për të arritur gradët më të larta të përsosmërisë humane.

Autori, gjatë gjithë veprës së tij "*Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin*", shfaqet me një mënyrë tejet tërheqëse e shumë estetike në komunikimin e tij me lexuesin. Duket qartë se ai nuk kërkon thjesht vëmendjen e tij, por i drejtohet zemrës, si kryeqendër e udhëzimit dhe e dashurisë. Mundohet ta marrë me të mirë atë, ta këshillojë me butësi e prekje emocionale, që ajo të nënshtrohet para duarve të tij, në rrugën e udhëzimit që ai ka nisur me lexuesin.

Ai, i drejtohet zemrave që ndiejnë, duke i përmendur "*një mik të Zotit...*" (Po aty, fq. 13), "*aventurat dashurore mes Mexhnunit dhe Lejlasë...*" (Po aty, fq. 18), "*Mevlananë që kërkon një ashk që nga flaka brenda tij të shpërthejë në kiamete...*" (Po aty, fq. 20), sahabiun Abdullah ibn Zejd, i cili pasi mësoi se Profeti (a.s.) kishte ndërruar jetë "*i hapi duart me zemër të djegur drejt selisë së lartë për t'u lutur: O Zot! Merrmi sytë tani! Pas vdekjes së Profetit tim që e kam dashur më shumë se çdo gjë, nuk dua të shoh më ndonjë gjë tjetër në këtë botë!...*" (Po aty, fq. 27)

I drejtohet zemrave të dashuruara pas Udhëzuesit dhe të dërguarit të Tij, duke nxitur

tallazet e mallit dhe djegies në thellësitë e tyre, kur u përmend poetin Mevlana, i cili shprehet: "*Eja, o zemër! Festa e vërtetë është bashkimi me Muhammedin, sepse ndriçimi i gjithësisë është nga drita e bukurisë së asaj qenieje të bekuar!*" (Po aty, fq. 29)

Dhe autori i dashurive udhëzuese e jetëdhënëse për zemrat e besimtarëve të



përmalluar për vetë dashurinë që i lë të zgjuar netëve me sexhde dhe ditëve me heshtje meditimi, vazhdon... me dashurinë për njerëzit e zgjedhur dhe të gjithë besimtarët.

Ai, sqaron se: "*Orientimi i dashurisë kah Allahu (xh.xh.) kërkon të duhen, në fillim Drita Muhammediane, pastaj qenia e shenjtë e Profetit (s.a.v.s.), miqtë e Zotit...*" (Po aty, fq. 30)

Autori, me këtë gjuhë, ndër të tjera, duket se kërkon të ngrejë lart edhe nivelin e komunikimit islam në rangjet e ndryshme

besimtare. Ai me thjeshtësinë e një edukatori dhe mjeshttrinë e një dijetari të thelluar në çështjet e besimit, mundohet të tërheqë lexuesin drejt një bote, për të cilën të gjithë kemi nevojë, e drejt së cilës të gjithë duhet të drejtohemi, pasi është bota e ndjenjave të pastra besimore, e zemrave të përmalluara, e inspirimeve ndriçuese dhe e komunikimeve nëpërmjet dritave...

Në librin "*Enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin*", lexuesi me zemër, prek ndjeshëm lotët e trungut të hurmës ku mbështetej Resulull-llahi (a.s.), atë ditë kur u vendos që Zotërisë së tij t'i ndërtonin një minber, prej ku do ta shihnin të gjithë gjatë ligjërimeve të tij. "*Profeti (s.a.s.) zbriti nga minberi dhe, duke e fërkuar trungun e hurmës me duart e tij të bekuara, e pyeti: "O druri i hurmës, ç'kërkon? Pse qan? Pse rënkon?" Dhe druri i hurmës nisi të fliste me gjuhën e vet. Mes lotëve të nxehtë, iu përgjigj: ... Dëshira ime e vetme është të shkrihem e të humbem në qenien tënde! Prandaj, më merr e më gropos që të kalbem, të humbem e të shpëtoj nga ky trup i vdekshëm!..."*" (Po aty, fq. 35-36)

Gjatë meditimit në detajet e kësaj ngjarjeje të mrekullueshme, të duket se zemra të flet me gjuhën e trungut të hurmës, e Resulull-llahu (a.s.) të fërkon me dorën e tij të butë e plot dritë, si për të të dhuruar sekretin e dashurisë së tij, të cilin e ndjen se po ta vendosë diku në thellësi të zemrës, si garanci e vazhdimësisë së

ndriçimeve udhëzuese dhe
rezatimeve dashurore nga qendra
e saj..!

Dhe e ndalova për një çast
shfletimin e kësaj vepre. Nga
thellësitë e zemrës më dolën ca
vargje, që pasi i dëgjova vendosa
t'i lexoj, për të qenë si një kurorë
mirënjohjeje për autorin Osman
Nuri Topbash, që nëpërmjet librit
të tij "*Enigma e dashurisë për
Allahun dhe Profetin*", më dhuroi
emocion dhe më ngjalli
nostalgji...

"O Unë...",
dëgjova mistikun në lutje,
me duar të bardha
drejtuar nga lartësitë.
"Kjo është dashuria!",
tha me shikim filladi,

i gëzuar, i mjeruar,
nga lidhja dhe malli.
"O Unë...",
dëgjova mistikun në lutje,
me sy-lot, shkëndijë,
drejtuar nga horizontet.
"Jetoj për dashurinë!",
tha me gjysëm zëri,
i lodhur, i ndritur,
nga lutja dhe visali.
"O...",
ndaloi dhe në heshtje,
më pa, me shenjë bëri:
"Dashuria kërkohet,
netëve të bardha,
"aheve" të zemrës,
si qiriu që shkrihet,
nga dashuria e dritës..."

Dhe iu riktheva librit... Aty,
personazhet e tij morën të më

flisnin e dialogu me ta u kthye në
një enigmë, që i ngjante vetë
titullit të këtij libri plot sekrete
dashurie e enigmash dashurore...

"*Enigma e dashurisë për
Allahun dhe Profetin*", ishte kthyer
në një mihrab dashurie, ku ngjyrat
e dashurisë përzier me ato të
lutjeve krijonin një ylber mistik,
që zbukuronte hapësirat, në mes
lotëve të nxehtë dhe lutjeve për
shkrirje në dashurinë e Tij...
Enigmat e dashurisë për All-llahun
dhe Profetin e Tij kishin mbuluar
horizontet...

Shkodër, më 03. 10. 2006

Autori, me këtë gjuhë, ndër të tjera, duket se kërkon të ngrejë lart edhe nivelin e komunikimit islam në rangjet e ndryshme besimtare. Ai me thjeshtësinë e një edukatori dhe mjeshtrinë e një dijetari të thelluar në çështjet e besimit, mundohet të tërheqë lexuesin drejt një bote, për të cilën të gjithë kemi nevojë, e drejt së cilës të gjithë duhet të drejtohem, pasi është bota e ndjenjave të pastra besimore, e zemrave të përmalluara, e inspirimeve ndriçuese dhe e komunikimeve nëpërmjet dritave...

LIGJET E PERGJITHSHME TE JETES PROFESIONALE.



Çdo punë dhe profesion në strukturën e vet ka rregullat dhe metodën e vet të punës. Meqë shqetësimi kryesor i çdo njeriu është arritja e suksesit dhe realizimi i dëshirave dhe i qëllimeve, po japim disa mënyra për të arritur sukses në punën tuaj. Vetëm duke i vendosur në praktikë këto këshilla nuk do të jetë e largët dita, kur do të hyni në rrugën e

Duhet ta dish se dashuria ndaj punës lind dhe forcohet përmes përballimit të problemeve. Kënaqësia shpirtërore që paraqitet pas kapërcimit të problemeve është e pashoqe. Të jesh i sigurtë se ngadhënjimi në luftë dhe sukcesi në punë janë me atë që nuk kthehet prapa. Përpara këmbënguljes, problemet shkrihen dhe të pamundurat bëhen të mundshme.

suksesit. Ja disa nga këto:

- Mos prit kohë dhe ditë të caktuara për punë. Dije se çdo orë dhe çdo ditë është e qëlluar për punë.
- Mos kërko vend të përshtatshëm për punë. Dije se çdo skutë mund të bëhet vendi më i përshtatshëm i punës.
- Asnjëherë punën e sotme mos e lër për nesër, për arsye se çdo ditë ka vështirësitë dhe punët e veta.
- Në një kohë të caktuar bëj vetëm një punë, vetëm një mësim, respektivisht puno rreth një problemi, derisa të mos dobësohet fuqia dhe kujdesi. Nëse thua se do të bësh më shumë punë për një kohë, atëherë asnjëherë prej tyre nuk do të mund ta bësh si duhet. Pa e kryer një punë, mësim, libër që e ke filluar mos kalo në tjetrën. Puna e mbetur përgjysmë është njësoj si të mos jetë nisur fare.
- Para se të fillosh punën,

mësimin merri të gjitha gjërat që do të nevojiten gjatë kryerjes se tyre, në mënyrë që të mos humbasësh kujdesin duke u ngritur pandërprerë për të marrë letër, laps etj.

- Në momentin kur nuk ke mundësi të përballosh një problem rreth çështjes për të cilën punon, mos bëj hapa prapa kurrë. Mos u frikëso nga dështimi. Dije që lëshimi pe, është përtaci e maskuar. Duhet ta dish se dashuria ndaj punës lind dhe forcohet përmes përballimit të problemeve. Kënaqësia shpirtërore që paraqitet pas kapërcimit të problemeve është e pashoqe. Të jesh i sigurtë se ngadhënjimi në luftë dhe sukcesi në punë janë me atë që nuk kthehet prapa. Përpara këmbënguljes, problemet shkrihen dhe të pamundurat bëhen të mundshme.
- Pikë së pari ndaje problemin me të cilin do të

ballafaqohesh, pastaj përpiku t'i zbërthesh pjesët e tij një nga një. Pikërisht në këtë mënyrë mësimin, edhe librin që e lexon ndaji në pjesë më të thjeshta dhe më të shkurtra. Para se ta kuptosh mirë një pjesë, mos kalo në tjetrën. Mos e hidh hapin e ardhshëm, pa qenë i sigurtë për të parin.

- Puno vazhdimisht dhe me kujdes si dhe përpiku të punosh çdo ditë në të njëjtën kohë. Mos e ndërpre punën për një kohë të gjatë. Nëse nuk je i sëmurë dhe i lodhur puno nga pak edhe gjatë pushimeve, në mënyrë që të mos e humbësh shprehinë e punës dhe mos ta kesh të vështirë t'i kthehesh përsëri.
- Asnjëherë mos e vlerëso produktivitetin e punës me orë dhe mos thuaj mjaft. Shihe rezultatit e punës me atë që ke mësuar.
- Ki besim! Bëje tënden shprehjen: "Unë jam i/e aftë dhe mund të arrij gjithçka".
- Në punët mendore mjaftojnë

dy-tri orë punë të pandërprera. Filozofi i madh anglez Spenseri veprat e veta i ka shkruar me një punë permanente 2 orëshe në ditë. Emil Zolanë e kanë pyetur për fshehtësinë e suksesit të tij: "Çdo ditë punoj dhe shkruaj nga tri orë", - është përgjigjur ai.

- Bëhu i qëndrueshëm. Gur, gur bëhet mur.
- Kur të shtrihesh në shtrat për të pushuar bëje llogarinë e asaj që ke bërë atë ditë dhe planifiko ç'do të bësh ditën e nesërme.
- Mësoji përmendësh pjesët e bukura që do t'i ndeshësh në ndonjë libër filozofik, ose letrar. Në këtë mënyrë do të të forcohet kujtesa.
- Pas përfundimit të leximit të pjesëve të një libri, përsëriti ato në kujtesën tënde dhe merr shënime. Mënyra më e mirë e përvetësimit të një materiali, është mbajtja shënim e tij.
- Pjesët dhe informacionet që ke mësuar prej ndonjë libri,

diskutoji më vonë me shokët. Në këtë mënyrë do të zhvillohet intelekti yt dhe do ta kuptosh atë që ke mësuar, njëkohësisht do të fitosh shkathtësinë e të shprehurit të qartë të mendimeve dhe ideve.

- Koha e punës mendore dhe produktiviteti i saj varen nga natyra e individit. Për dikë, kjo kohë është në orët e hershme të mëngjesit, për dikë në mesditë, ndërsa për dikë tjetër në orët e vonshme të natës. Provo veten se cila kohë të përshtatet më tepër për punë dhe mos e harxho kot atë.
- Para së gjithash mëso të flasësh dhe të shkruash mirë në gjuhën amtare. Gjëja më e rëndësishme për njeriun është gjuha e tij amtare. Vlera e individit është e shprehur në gjuhën dhe në majën e lapsit të tij. Ajo shfaqet nëpërmjet fjalës dhe shkrimit.
- Atëherë kur mendon për të filluar ose jo ndonjë punë,

Në punët mendore mjaftojnë dy-tri orë punë të pandërprera. Filozofi i madh anglez Spenseri veprat e veta i ka shkruar me një punë permanente 2 orëshe në ditë. Emil Zolanë e kanë pyetur për fshehtësinë e suksesit të tij: "Çdo ditë punoj dhe shkruaj nga tri orë", - është përgjigjur ai.



mendo për pasojat e dy vendimeve. Zgjidh atë nga i cili ke më shumë dobi e më pak dëm.

- Harroje të kaluarën. Shikoji gjërat në sensin pozitiv. Mëso nga gabimet e tua dhe ec përpara falë mësimave që ke nxjerrë.
- Analizo me përpikmëri aftësitë, mundësitë e tua personale në gjendjen aktuale të aktivitetit tënd. Shqyrto vullnetin tënd, burimet e tua fizike, intelektuale dhe morale.
- Mos u bëj për tërë jetën një i nënshtruar, ose një i pakënaqur, skllav i punës tënde, i trazuar nga rebelime të brendshme e i persekutuar nga nostalgji të vazhdueshme për “atë që do të kishit mundur të bënit”.
- Mos fol shumë, por fol me vend dhe domethënie. Vlera dhe ndikimi nuk mbështeten në fjalë të shumta, por në fjalët me vend dhe domethënie. Ki kujdes gjatë përdorimit të gjuhës dhe dije se plaga e shkaktuar nga gjuha të dhemb shumë më tepër se plaga e shkaktuar nga thika.
- Mosdijen mos ia përplas askujt në fytyrë. Dije se theksimi i paditurisë në prani të tjerëve do të jetë shkas për hidhërimi e bashkëbiseduesit.
- Para se të premtosh diçka, mendo mirë, por kurrë mos e shkel fjalën e dhënë. Shkelja e premtimit është gënjeshtër më e keqe.
- Gjithnjë paraqitu si je dhe bëhu ashtu siç paraqitesh. Ai që mundohet të paraqitet ashtu si nuk është në të

vërtetë është tejte mendjelehtë.

- Mos urre dhe mos ndiej zili ndaj suksesit dhe lumturisë së askujt, por përpigu që edhe ti ta arrish këtë sukses dhe lumturi. Përpjekja është kusht i përparimit. Urrejta dhe zilia janë dy armiqtë kryesorë të shëndetit, qetësisë shpirtërore dhe lumturisë.
- Gjithmonë përpigu ta zbukurosh moralin. Bukuria morale është pasuria më me vlerë e njeriut.
- Miqësinë vërtetoje në ditë të vështira, që të kesh miq në ditë të vështira.
- Mos u bëj mendjemadh për shkak të suksesit tënd. Dije që mendjemadhësia është armiku më i madh i suksesit në të ardhmen.
- Bëhu guximtar në jetë, por ki kujdes, guximi nuk është hedhje në rrezik me sytë mbyllur.
- Shpreh respekt ndaj mendimit dhe besimit të tjerëve, që edhe të tjerët ta respektojnë mendimin dhe besimin tënd.
- Mos i bëj tjetërkujt asgjë që nuk dëshiron të të bëhet ty, në mënyrë që edhe të tjerët të mos veprojnë ashtu ndaj teje.
- Ndihmoje njeriun e shtypur, që të ndihmohesh, nëse edhe vetë shtypesh.

Literatura e shfrytëzuar:

1. “ Kokë më kokë me të rinjtë ” - Ali Fuad Bashgil
2. “ Suksesi në jetë ” - Harry Box



Një ngjarje e dhimbshme emigrimi dhe Ummu Seleme

Fatma Kuru



Për një vit me radhë Ummu Seleme mëngjeseve dilte në vendin e quajtur Ebtah, qante gjithë ditën dhe në mbrëmje kthehej në shtëpi. Një ditë e pa djali i xhaxhait dhe u merakos nga gjendja e saj. Ai iu drejtua fisit të saj: Ju e ndatë këtë grua të shkretë nga burri dhe djali, pse nuk e lini të lirë tani?

Emri i vërtetë ishte Hind. Babai quhej Ebu Umejje dhe ishte nga fisi i Mahzunëve ndërsa e ëma quhej Atike bint Amir. Ummu Seleme ishte martuar me Abdullah bin Abdu'l-Esedin. Për shkak të vuajtjeve të shumta që përjetuan në vitet e para të përhapjes së Islamit kjo familje myslimane emigroi në Habeshistan. Të katër fëmijët Zejnep, Seleme, Umer dhe Durre i lindi gjatë kohës që qëndruan në kurbet. Duke parë kthimin në myslimanë të shumë mekasve ato shpresuan se çdo gjë kishte ndryshuar, por përsëri nuk gjetën atë që prisnin. E kuptuan se jeta me mosbesimtarë dhe mohues të Zotit në Mekke ishte e vështirë dhe thuajse e pamundur. Kur Allahu (xh.sh) i urdhëroi myslimanët që të emigronin në Medine Ebu Seleme filloi menjëherë përgatitjet. Ummu Seleme tregon:

“Ishte një vit para lidhjes së Akabes, kur burri im Ebu Seleme e mori vesh që mund të shkonim në Medine. Përgatiti edhe për mua një deve dhe djalin e vogël Seleme ma vendosi në prehër që të tërhiqte devenë. Kur na panë burrat e fisit tim, Benu Mugire u afruan dhe thanë: Ti kujton se ne do të të lejojmë që ta shpiesh këtë grua nga një vend në tjetrin dhe duke më tërhequr prej tij nuk e lanë të pengonte devenë. Kur e morën vesh fisi i Ebu Selemesë u përgjigjën: “Meqë ju ia morët

gruan djalit tonë atëherë edhe ne nuk do të lëmë në duart tuaja djalin e tij. Ato filluan të grindeshin mes tyre aq fort sa që duke e tërhequr djalin ia nxorën dorën. Në fund fisi i Ebu Selemesë ia mori djalin dhe Ebu Seleme emigroi në Medine. Kështu ajo mbeti në Meke e ndarë nga burri dhe djali, ndërsa ai u bë nga myslimanët e parë që emigruan në Medine.

Për një vit me radhë mëngjeseve dilte në vendin e quajtur Ebtah, qante gjithë ditën dhe në mbrëmje kthehej në shtëpi. Një ditë e pa djali i xhaxhait dhe u merakos nga gjendja e saj. Ai iu drejtua fisit të saj: Ju e ndatë këtë grua të shkretë nga burri dhe djali, pse nuk e lini të lirë tani? Dhe ato mu përgjigjën: N.q.s dëshiron shko tek burri yt.

Edhe fisi i burrit e solli djalin, Selemenë. E mori djalin, i hipi devesë dhe u nis krejt e vetme drejt Medines. Kur iu afrua Tenimes u takua në rrugë me Uthman ibn Talha nga fisi Abd'u-Dar i cili iu drejtua duke i thënë:

-Për ku je nisur o vajza e Ebu Umejjes?

-Po shkoj në Medine të bashkohem me burrin.

-A nuk je e shoqëruar me njeri?

-Nuk kam askënd tjetër përveç Allahut dhe djalit tim.

-Ti nuk mund të liresh vetëm. E tërhoqi devenë për tu nisur bashkë me të. Ajo nuk kishte parë ndonjëherë njeri më të mirë në

mes të arabëve sesa ai. Sa herë që ndaleshin për të pushuar largohej dhe priste sa të zbriste nga deveja. Më vonë kthehej e lidhte atë për një pemë ndërsa ai vetë qëndronte nën një pemë tjetër. Kur bëheshin gati për t'u nisur përgatiste devenë dhe duke kthyer shpinën drejtohej:

-Mund të hipësh !.

Ku iu afruan Kubas tha:

-Ebu Seleme ndodhet këtu, tashmë mund të shkosh vetë dhe duke e përshëndetur u kthye në Mekke. Të tjerët nuk e besuan ardhjen nga Mekeja të Ummu Selemesë.

Nga plagosja e rëndë Ebu Selemeja vdiq në vitin e katërt të hixhretit dhe Ummu Seleme mbeti e ve. Një ditë para se të vdiste ajo i kishte folur me këto fjalë: "Kam dëgjuar se n.q.s një gruaje i vdes burri i saj i cili është nga banorët e xhenetit e ajo nuk martohet me tjetër njeri atëherë Allahu i bashkon në botën tjetër. E njëjta gjë është në rastin kur një burri i

vdes gruaja dhe nuk martohet më. Atëherë le t'i premtojmë njëri – tjetrit se mbas vdekjes së ndonjërit prej nesh nuk do të martohemi me tjetër njeri. Ebu Selemeja iu përgjigj:

-N.q.s më dëgjon mua, unë të lejoj që të martohesh mbas vdekjes sime.

Pas këtyre fjalëve iu lut Zotit që Ummu Selemeja të martohej me një më të mirë se ai që ta donte dhe respektonte siç e meritonte. Kur Ebu Selemeja vdiq e pyeta Pejgamberin (a.s.):

-O Resulallah Ebu Selemeja vdiq, tani si duhet të bëj dua? Dhe Pejgamberi iu përgjigj:

- Thuaj: Zoti im më fal mua dhe më lidh më vonë me një njeri më të mirë se ai. Unë mendoja me vete se kush mund të ishte më i mirë se Ebu Selemeja. Më në fund Pejgamberi (a.s.) më kërkoi që të martohesha me të. Edhe pse kam qenë pak xheloze dhe jam shqetësuar për fëmijët e mi


Pejgamberi më thoshte:

- Shpresoj që Allahu ta heqë xhelozinë dhe përsa i përket fëmijëve ato janë si të mitë. Kur të plakemi do ndihmojmë njëri-tjetrin.

Unë nuk i kisha prindërit afër dhe për këtë arsye i thashë djalit tim të madh Umerit që të më kurorëzonte me Pejgamberin (a.s.). Në këtë mënyrë një nga gratë e pejgamberit tonë Ummu Seleme e kuptoi shumë mirë rëndësinë e duasë së bërë, sepse Allahu i dha një njeri më të mirë pas vdekjes së burrit. Ajo ka qenë e shquar në fushën e fikhut (jurisprudencës islame). Ka transmetuar 378 hadithe nga Pejgamberi (a.s.). Namazi i xhenazes iu fal në varrezën Baki në të cilën edhe u varros. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të.

AISA KADUKU

Ummu Seleme ka qenë e shquar në fushën e fikhut (jurisprudencës islame). Ka transmetuar 378 hadithe nga Pejgamberi (a.s.). Namazi i xhenazes iu fal në varrezën Baki në të cilën edhe u varros. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të.



Boja e shkrimit blözë



Bloza e dalë nga pisha ose vaji i ullirit nuk mund të pranohet për shkak të përbërjes së madhe të vajit që ka. Ajo që futet në përbërjen e bojës së shkrimit të blözës dhe që e përcakton atë mbi letër është zamka (ngjitësja e prodhuar nga akacia).

Nuk duhet të ngatërrohet boja e shkrimit blözë e përdorur në historinë Islame e për më tepër në artin e kaligrafisë me bojën kineze të shkrimit (ose Galat). Përbërja e kësaj boje dhe vendet ku përdoret janë krejt të ndryshme. Bloza që është në përbërjen e bojës së shkrimit të blözës përpunohet nga materiale të tilla si: vaj liri që jep blözë kur përpunohet, dyll bletësh, vaj mineral, vaj natyror. Bloza e dalë nga pisha ose vaji i ullirit nuk mund të pranohet për shkak të përbërjes së madhe të vajit që ka. Ajo që futet në përbërjen e bojës së shkrimit të blözës dhe që e përcakton atë mbi letër është zamka (ngjitësja e prodhuar nga akacia). Për të bërë bojën e shkrimit të blözës ka shumë formula me shkrim që kanë mbërritur deri në ditët tona. Mënyra e përgatitjes së kësaj boje shkrimi ka ndryshuar me kohën dhe më në fund përbërja e saj më e plotë ka qënë “Bloza është një përbërje e përbërë nga tretësirë zamke dhe ujë”. Boja e shkrimit

e përdorur për të shkruar veprat e artit ruhej vetvetiu.

Për tharjen e shkresave zyrtare hidhej në letër një lloj pluhuri i imët i quajtur rih (thithëse boje) (ose rik)

Boja e shkrimit e blözës që shkrimtarët mbanin përherë me vete në një kuti qindra vite më parë meqënëse me kalimin e kohës nuk pësonte ndonjë ndryshim në ngjyrë metoda Perëndimore ka patur një epërsi ndaj bojës së shkrimit.

Boja e shkrimit nuk është praktike për lapsat e sotëm, ndërsa për laps kallami është e mrekullueshme. Asnjëra nga bojërat e zeza të dala në kohët e sotme bashkëkohore dhe moderne nuk mund ta zërë vendin e saj pasi kjo bojë shkrimi është një përzierje e lëngshme blöze. Pra, copëzat e vogla të blözës kanë mbetur në ujë të pashkrira me ndihmën e zamkës. Aharli kur shkruhet në letër mbetet në sipërfaqe dhe është e mundshme të fshihet bile edhe të pastrohet. Kjo është e nevojshme për

shkrimet e vjetra të artit dhe shprehja e përdorur për njerëzit që kanë studiuar “Paska pirë tepër bojë shkrimi” vjen pikërisht nga kjo.

BOJRAT E SHKRIMIT ME NGJYRA

Edhe pse gjatë historisë sonë janë prodhuar bojra shkrimi me ngjyra të ndryshme ato që përdoren më tepër janë: e verdha (zirniki), e kuqja (lal), e bardha (ustubeç) dhe floriri (zer)

Boja e shkrimit Zirniki (e verdhë): Përzierja pas një shtypjeje të fortë të sulfurit të sodiumit dhe arsenikut të njohura me emrin “Zirniki” me tretësirën e zamkës jep këtë bojë shkrimi me ngjyrë të verdhë.

Boja e shkrimit lal (e kuqe):

Pasi lëndët e tilla si: lotur + sekerci çogeni + sap + ujë përzihen dhe vlohen, u merret uji në të cilin hidhet lënda e tharë e “kirmizboçegi” (insekt i vogël) duke u rrahur mirë. Boja e

shkrimit lale e realizuar pikërisht me vlimin përsëri të përbërjes ka një ngjyrë të kuqe tepër joshëse.

Boja e shkrimit ustubeç (e bardhë): Bëhet në të njëjtën metodë por në vend të zirnikut përdoret ustubeç. Kjo lloj boje përdoret më tepër në shkrimin e titujve të sureve dhe mbi fushën e artë.

Boja floriri e shkrimit: Shtypja dhe shkrirja në një pjatë porcelani të varakëve prej floriri, të ndarë dhe të holluar aq sa të maten me mikrona, rrahja e tyre në mënyrë të rregullt me ndihmën e tretësirës së zamkës apo të mjaltit dhe mbledhja në anën e një pjatë tjetër duke u larë me ujë dhe kulluar na jep pikërisht ato grimcat e vogla të floririt që janë baza e bojës së shkrimit. Në kohën kur përdoret, duke i shtuar ujë me xhelatinë dhe me furçë, zhytet në gojën e lapsit të kallamit dhe shkruhet; Baza e shkrimeve Zer-endud (flori i lyer) është pikërisht kjo.

Në kohët kur është përdorur lapsi prej kallami dhe boja blozë e shkrimit për të shkruar, në kompletet e shkrimit apo në sirtaret e shkrimit, ndërsa kutia e bojës së shkrimit e cila ishte patjetër si komplet shkrimi i përdorur kryesisht nga njerëzit e dijes ishte një nga pikat më të rëndësishme të jetës kulturore Islame. Zakonisht kutitë minerare kanë patur formë cilindrike me një fund dhe me dalje në anë të quajtur tub i gjatë ku vendoseshin lapsat prej kallami. Vendosja e bojrave të shkrimit në kuti; një masë prej kumashi, lëndë e parë e quajtur lika nëse vendoset në

kuti dhe boja e shkrimit derdhet pikërisht mbi të, lika e thith bojën e shkrimit si sfungjer dhe me zhytjen e lapsit shumë lehtë në të e ngjesh majën e lapsit aq sa është e nevojshme.



Në përmbatjen e veprës së shkruar rregulli i rreshtave të pjesës që do të shkruhet, llogaritet sipas përmasës së pikës së lapsit prej kallami që do të përdoret për këtë qëllim dhe përcaktohet me një vijë mbi një karton në madhësinë e faqes.

Mistari

Vendosja në një rresht një gërme apo disa gërmave në artin e shkrimit dhe rreshtimi i tyre në një vijë të drejtë përcaktohet në disa formula. Kjo është e tillë në alfabetin Latin. Në historinë

Islame është vlerësuar një mjet i thjeshtë që vlen për përcaktimin e vijave të rreshtit dhe që njihet me emrin mistar.

Në përmbatjen e veprës së shkruar rregulli i rreshtave të pjesës që do të shkruhet, llogaritet sipas përmasës së pikës së lapsit prej kallami që do të përdoret për këtë qëllim dhe përcaktohet me një vijë mbi një karton në madhësinë e faqes; fillimi dhe fundi i rreshtit çelet me gjilpërë.

Përdorimi i mistarit bëhet në këtë mënyrë: Çdo pjesë e letrës së tjetërsuar, duke u vendosur mbi mistar, sipas rregullit të faqes; çdo fije e larë në vaj, nëse rrotullohet mbi vijat e rreshtave, gjurmët e tyre dal në letër dhe shkrimet shkruhen pikërisht sipas këtyre gjurmëve.

Mbështetësja e shkrimit

Piktorët e vjetër nuk uleshin në karrige të shkruanin mbi tavolinë, pasi uleshin në mindere, gjunjazi dhe shkruanin mbi gjurin e djathtë. Ruajtja e këndvështrimit në 90 gradë dhe mbajtja në rregull mbi gju të letrës është e lidhur me vendosjen mbi gju të një mbështetëse të përgatitur me vendosjen njëra mbi tjetrën të letrave me përmasa 20-25 cm që të vjetrit i quanin zir-i meshk (mbështetëse e ushtrimit të një diçkaje). Mospërdorimi i një sipërfaqeje të fortë është për të mundësuar një lëvizje të lehtë të dorës.

EVANS DRISHTI

Këtej kaloi një Papë dhe Pas “Kuintave” në Stamboll

Mes datave 28 Nëntor - 1 Dhjetor Papa Benedikti XVI vizitoi Turqinë. Një vizitë kjo e shumëdiskutuar nëpër shtypin perëndimor për faktin se si do të pritej Papa në Turqi pas valës së zemërimeve që krijoi me anë të pohimeve të tij në konferencën e zhvilluar në qytetin Regensburg të Gjermanisë. Ndërsa e përmuajshmja TIME e komentonte këtë vizitë të Papës si një nismë të re për një risendërtim të debateve mes botës Muslimane dhe asaj të Krishterë, specialisti Henri Tincq i gazetës franceze Le Monde shkante më tej me komentet e tija duke e parë vizitën e Papës si një shprehje të makthit të drejtuesit shpirtëror për rrënimin e vlerave të krishtera në Europë përballë radikalizmit Islam. Ndërsa Kryepeshkopi Mamberti do të mjaftohej duke thënë se: “Papa ndjehet i lumtur që do të vizitojë një vend musliman si Turqia”.

Kryeministri turk Tajip Erdogan takohet me Papën

Kryeministri turk Tajip Erdogan i cili dy ditë para datës së vizitës së papës ishte shprehur se mund të mos takohej me drejtuesin shpirtëror të botës katolike për shkak të mbledhjes së shteteve të Natos në Letoni, gjë për të cilën ishte njoftuar edhe sekretariati i Vatikanit, e vonoi disa orë nisjen e tij drejt Letonisë me dëshirën e mirë për të pritur Papën dhe për t'i uruar mirëseardhjen në Turqi. Pas takimit 25 minutësh që zgjati mes tyre, në deklaratën e dhënë shtypit Erdogani tha se: “Në një periudhë



të vështirë kur po vjen duke u rritur kultura e agresionit dhe gjendemi ballë për ballë me skenare të kobshme që parashohin përplasjen e qytetërimeve kemi nevojë më shumë se kurdoherë për mirëkuptimin e anasjelltë në mes besimeve dhe kulturave të ndryshme”. Me këtë rast Kryeministri turk i dhuroi Papës një ibrik prej argjendi dhe një pjatë porcelani të dekoruar, që të dyja prodhime karakteristike të artizanatit klasik turk.

Dy liderët fetarë i shtrëngojnë duart njëri-tjetrit

Me datë 28 nëntor papa Benedikti XVI vizitoi selinë e Komunitetit Musliman të Turqisë ku u prit nga Kryetari i këtij Komuniteti, Prof. Ali Bardakoglu. Në mbledhjen me dyer të mbyllura të dy përfaqësitë përbëheshin nga 11 persona. Më pas të dy liderët

shpirtërorë dolën sëbashku përpara kamerave. Prof. Ali Bardakoglu, i cili ia nisi deklaratës duke thënë me zë Bismilahi'r-Rahmanir-Rahim mes të tjerash tha: “Kohët e fundit jemi dëshmitar të përshkallzimit të Islamofobisë, mendësi që kërkon t'i bind të tjerët se feja Islame është përhapur me forcën e shpatës dhe se muslimanët përbëjnë një potencial të rrezikshëm për dhunën. Do të deklaroja publikisht këtu përpara jush se çdo pasues i këtij besimi, emri i të cilit rrjedh nga fjala paqe, ndjehet thellësisht i prekur në shpirt nga këto akuza dhe pretendime të pabaza që nuk mbështeten në asnjë hulumtim apo të dhënë historike a shkencore”

Masa të tilla sigurie nuk ishin parë ndonjëherë

Me përjashtim të një grupi të vogël prej 15 vetësh të cilët

organizuan një protestë të vogël përpara faltores së vogël të Shën Sofisë, faltore kjo që gjendet përpara çeshmes së famshme të sultan Ahmedit dhe Portës së Parë që të shpie tek Topkapı Saraji, protestë që në televizionet turke u shfaq herë pas here për të treguar përpikmërinë e ekipeve policore tek rendnin për ta rrethuar këtë grup të vogël, ndërsa një pjesë e shtypit perëndimor i servirnin pamjet në ekranet e tyre për të krijuar sensacionin e personave të rrezikshëm që mund të bënin të përsëritej histori tashmë në zemër të Stambollit, pjesa më e madhe e qytetarëve turq as që i kushtuan rëndësi kësaj vizite. Që b a s h k ë s i a muslimanëve fetarë nuk e shihnin dhe me aq sy të mirë ardhjen e papës të frikësuar nga ideja e një unifikimi të madh mes dy kishash, pohim shumë i pëlqyer nga ideuesit e teroive të komplotit, por tërësisht e refuzuar nga intelektualët dhe historianët turq si diçka e pamundur për kohët e sotme, banorët turq që popullojnë zonat e Stambollit të njohura si bastione të laikëve as që nuk e vunë në refenë

dhe nuk i kushtuan rëndësi ardhjes së një pape. Por do të ishin këta banorë të Stambollit të cilët ditët e vizitës së papës do të ballafaqoheshin me masa aq të rrepta sigurie duke nisur nga mbyllja e trafikut për rrugët kyçe të Stambollit nga të cilat kalojnë pjesa më e madhe e autobuzëve urbanë. U bllokuan rrugët prej Unkapanit deri në Taksim si dhe ajo që lidh këtë të fundit me

Mexhdijekëjin (Mecidiyeköy), që për një turist apo person që ka pasur rastin të vizitojë Stambollin e di mirë ç'do të thotë. Ishte e pamundur të mos shihje pamje të njerëzve përgjatë rrugës që të mos flisnin nën zë dhe të ndjeheshin të revoltuar tek shihnin se planet e tyre të atyre ditëve të punës të kishin shkuar ters.

Rrugët e mbyllura për kalimin e çdo lloj mjet transporti, që patrulloheshin nga makina policie, e kyçën trafikun e Stambollit i cili



edhe në ditë normale është tejet i ngarkuar. Qytetarët të cilëve ju desh të qëndrojnë për orë të tëra brenda mjeteve të transportit publik dhe personal e shprehën reagimin e tyre duke u rënë borive me sa fuqi që kishin kur u ballafaquan me këtë situatë të patritur ditën e parë. Ata që gjendeshin brenda mjeteve publike iu desh të zbrisnin dhe të ecin me orë të tëra për të mbërritur në banesat e tyre. Rrugët

që të çojnë në lagjen Harbiye ku gjenden Konsullata e Vatikanit, ku qëndroi papa gjatë ditëve të vizitës në Stamboll, u kontrolluan imtësisht nga ekipe policësh të veshur dhe civil. Edhe rruga Abdulazez Pasha ku ndodhet Patrikana Ortodokse e Strambollit u mbyll për çdo kënd. U mbyllën për kalimtarët dhe mjetet e transportit edhe rruga Balat-Unkapan-Taksim nga do të kalonte vargu i makinave. U pezulluan edhe udhëtimet me rrugë detare midis Sirkexhiut dhe Haremit.

Ja se si u shpreh gazetarja Jasemin Baj, gazetare e shtypit laik, që punon në gazetën Milijet: “Si një qytetare që banon në rrugën ku gjendet Konsullata e Vatikanit ashtu sikurse të gjithë banorët e tjerë të lagjes edhe unë u rregjistrova te ekipi ambulant i policisë duke u dhënë fotokopjen e letërnjoftimit tim. Por mbrëmë teksa kthehesha në orën 23:00 për në shtëpi nuk arrita të hyj në rrugicën ku banoj. Policët më ndalën dhe nuk deshën të më lënë të kaloja duke u shprehur se emri im nuk figuronte në listën që kishin me vete?! Më lanë të kaloja vetëm duke më shoqëruar me një polic civil i cili u largua vetëm pasi u sigurua se unë kisha hyrë në banesën time. E njëjta gjë ndodhi edhe të nesërmen. Edhe të pasnesërmen. Mbase të mërzhitur me mua policët më dhanë një këshillë: Përse nuk rri brenda në shtëpi dhe nuk del jashtë për sa ditë që papa ta jetë këtu?!?”

Arjan Ymeraj



Skizofrenia shërohet me mbështetjen e familjes

Në sëmundjen e skizofrenisë që ndikon individin së bashku me rrethin e tij, një rëndësi të madhe ka edhe mbështetja familjare. Sa më shumë të jetë e informuar familja në lidhje me sëmundjen dhe sa më shumë ta ndjekë kurimin e saj duke u takuar me doktorin dhe ekipin e tij, aq më shumë do të ndihmojë në shërimin e të sëmurit.

Pesha e tepërt në shtatzani shkakton tension

Specialistët theksojnë se kandidatet nëna në periudhën e shtatzanisë duhet t'u kushtojnë kujdes ushqimit të tyre: ato paralajmërojnë se gratë që kanë peshë të tepërt në këtë periudhë hasen me problemin e tensionit të lartë, ndërsa ato që ushqehen në mënyrë të pamjaftueshme, mund të hasen me rrezikun e lindjes para kohe.

Përdorimi i cigares dhe i alkoolit të çon në pneumoni

Shkaku i vetëm i sëmundjes së pneumonisë që është shkak i vdekjes çdo vit të 60 mijë individëve në Turqi, nuk është të ftohurit ashtu siç është pandehur.

Djemtë janë më hiperaktivë në raport me vajzat

Hiperaktiviteti, sjellja më e rëndomtë e

përcaktuar në periudhën e fëmijërisë, është ëndrra e frikshme e familjeve.

Fëmijët që kanë të tilla probleme, nëse do të shoqërohen me pakujdesitë e familjeve të tyre, do të paraqesin momente të vështira edhe për mësuesit.

Dhomat e paajrosura të bëjnë të sëmurë

Mosajrosja e mjaftueshme e ambienteve në periudhën e dimrit me ankthin se "bëhet ftohtë" lehtëson marrjen e viruseve që bëhen shkak të sëmundjeve të bllokimit të rrugëve të frymëmarrjes.

A duhet të diskutojnë familjarët situatat ekonomike me fëmijët e tyre?

Shumë prindër e shohin problemin ekonomik të rimëkëmbjes së familjes, si një temë që s'flitet pranë fëmijëve. Kurse në fakt, kjo situatë bën që fëmijët mos ta kuptojnë në mënyrë të mjaftueshme vlerën e parasë. Prandaj bisedat e familjarëve pranë fëmijëve të tyre në lidhje me këto probleme mbartin rëndësi të madhe që fëmijët të konceptojnë domethënien e jetesës familjare.

Shërbimi ditor në spitalet shtetërore i lumturon të sëmurit

Ministria e Shëndetësisë që po përgatitet të fusë sistemin e akreditacionit për të rritur cilësinë e shërbimit shëndetësor përcaktoi se në ato spitale ku zbatohet ky sistem, të sëmurët janë tepër të kënaqur.

Plotësojeni nevojën tuaj për energji me pekmez

Pekmezi ka një rol të rëndësishëm në ushqimin e trupit me vitamina dhe minerale. Ai është përcaktuar si një ushqim që nuk duhet të nënvlerësohet në periudhën e dimrit për t'i dhënë trupit energji dhe forcë.

Kam shumë vështirësi për të fjetur në programin e mësimit

Një kandidat që dëshiron sukses në provimin e universitetit nuk duhet ta ndryshojë shpesh programin mësimor, ndryshimet e nevojshme duhen bërë brenda programit mësimor.

Mbroni fëmijët dhe të moshuarit nga aksidentet e shtëpisë

Sipas studimeve të bëra nga aksidentet e ndodhura në shtëpi më shumë dëmtohen të moshuarit dhe fëmijët. Me masat që mund të merren këto aksidente mund të pakësohen dukshëm.

Kërcitja e dhëmbëve mund të shkaktojë alergjinë

Kërcitja e dhëmbëve e cila njihet në gjuhën mjeksore me emrin “bruksizëm” mund të vihet re në çdo moshë. Bruksizmi, që është një sëmundje që vihet re gjatë gjumit, mund të vijë e treta sipas radhës, pas të folurit në gjumë dhe gërhitjes.

Antibiotikët e panevojshëm rrisin bronshitin alergjik tek fëmijët

Bronshiti alergjik që vihet re me kollitje, lodhje dhe mungesë frymëmarrjeje është i dukshëm më shumë tek fëmijët. Sipas të dhënave të (WHO) Organizata Botërore e Shëndetësisë, mungesa e frymëmarrjes, si një sëmundje që vihet re në më shumë se 300 milionë njerëz në të gjithë botën, vjen pas bronshitit alergjik.

Mos mendoni se është një lodhje e thjeshtë

Dukjet e lodhjes kronike: lodhja që nuk kalon, pafuqishmëria pas një aktiviteti fizik apo mendor, zgjimi në mënyrë të lodhshme, harresa, dhimbja e kokës etj.

Specialistët paralajmërojnë: frika e vdekjes hap probleme tepër serioze tek fëmijët

Nëse një fëmijë flet dhe frikësohet vazhdimisht për vdekjen duke mos patur asnjë arsye mund të ndodhë edhe ndonjë çrregullim me vdekjen. Kjo situatë del në dukje e lidhur në mënyrë të dukshme me lajmet në lidhje me vdekjen apo me mënyrën e jetesës së fëmijës.



Interneti Feston Pesëmbëdhjetë Vjetorin e Shpikjes



kompanive telefonike të bien në vështirësi. Kjo karakteristikë ka marrë 1 % të votave.

Në muajin Korrik të vitit 2005 American Online ka organizuar një koncert madhështor me qëllim që t'i ndërgjegjësojë njerëzit ta luftojnë varfërinë që ka filluar ta kaploj botën. Ky koncert është ndjekur me anë të internetit nga rreth pesë milion njerëz dhe ka marrë 1 % të votave të kësaj anketë.

13 % të votave i ka marrë transmetimi i pamjeve filmike të Cunamit dhe tragjedia e 11 shtatorit që janë xhiruar nga kamerat amator.

Ndërsa 21 % të votave i kanë marrë sitet të cilat janë bërë shkak për humbjen dhe fitimin e trilionat dollarëve me anë të internetit.

Në vitin 1995 Hotmail ka filluar veprimtarinë e tij. Pas tridhjetë muajsh përdorimi i këtij web siti ka arritur në tridhjetë milion. Ndërsa sot ai numëron rreth dyqind e pesëmbëdhjetë milion përdorues të tij dhe ka arritur të marrë 4 % të votave në këtë anketë.

Kurse Google është bërë një gjigand i madh ekonomik, për arsye se përdoruesve të internetit ua ka bërë të lehtë gjetjen e adresave të ndryshme si reklamat etj. Nga anketa e bërë 40 % të votave i ka marrë ky web sit.

Interneti këtë vit feston pesëmbëdhjetë vjetorin e shpikjes së tij. Ai për një kohë kaq të shkurtër ka bërë bujë të madhe në të gjithë globin në fushën e ekonomisë, informacionit, komunikimit etj. Që nga fillimi i përdorimit të tij, deri në ditët tona "Google" ka arritur që të behët web siti më i vizituar nga përdoruesit e internetit.

Sipas një ankete të bërë nga kanali televiziv CNN thuhet që në këto pesëmbëdhjetë vjet web siti më i vizituar dhe i preferuar nga përdoruesit e internetit është Google me rreth 40 % vizitues. Në sajë të "Word Wide Web (WWW)" dhe "Protokol http" është bërë e mundur që për një periudhë të shkurtër nga krijimi i internetit të hapen më shumë se 1 miliardë faqe në të gjithë

globin.

Interneti, ka bërë të mundur që t'i afroje njerëzit më afër njëri-tjetrit, krijimin dhe zhvillimin e punëve të reja. Sipas anketës së zhvilluar nga kanali CNN, me rastin e pesëmbëdhjetë vjetorit të internetit kategoritë më të preferuara nga përdoruesit e internetit janë këto:

Përdorimi i internetit pa kabëll në mjediset e aeroportit, hotele, restorante etj. është pëlqyer shumë nga përdoruesit e internetit dhe ka marrë rreth 4 % të votave të anketës.

2 % të votave të anketës i kanë marrë "web camera"-at dhe "fotografitë" me anë të se cilave komunikimi është bërë më i lehtë dhe i përsosur.

Komunikimi i njerëzve me anë të internetit është bërë shkak që një pjesë e madhe e

Yahoo po krijon Bibliotekë Elektronike



Yahoo ka vendosur që me anë të krijimit të kësaj biblioteke elektronike t'ia kalojë rivalit të tij Google. Ai, ka në plan që me krijimin e kësaj biblioteke elektronike t'ia bëjë lexuesit punën më të lehtë që të gjejë me qindra mijëra libra sëbashku me tekstet e plota.

Deri tani Google nuk ka qenë i suksesshëm ta realizojë këtë projekt. Por Yahoo mendon që me këtë projekt do të bëhet i suksesshëm që t'u shërbejë të gjithë lexuesve që përdorin internetin. Shumë organizata kanë

vendosur që ta përkrahin Yahoo-në me këtë projekt në mënyrë që të krijohen kushte më të volitshme për studiuesit akademikë që kështu do ta kenë më të lehtë leximin e plotë të librave dhe versionet dixhitale të xhirimit të zërit dhe videove të ndryshme. Edhe ato shtëpi botuese, autorë librash etj. që me vullnetin e tyre kanë dëshirë që t'u paraqiten librat e tyre me tekst të plotë në internet do ta kenë këtë mundësi falas nga Yahoo.

Ortakët e Yahoo-s për të realizuar projektin e bibliotekës teknologjike, janë këto: Hewlett-

Packard, internet Archive, O'Reilly Media dhe universitetet e Kalifornisë dhe të Torontos. Yahoo, për të siguruar leximin e këtyre librave do të vendos një motor kërkues në siten www.opencontentalliance.org. Por në sajë të radhitjes dhe indeksit të këtyre librave do të bëhet e mundur që edhe nga Google dhe motorët e tjerë kërkues të krijojnë lehtësi për gjetjen e tyre.

Ndërsa Google, është duke bashkëpunuar me universitetet e Harvardit, Stanfordit dhe Michiganit, si afat të fundit për padi lexuesve u ka dhënë datën 1 Nëntor dhe si përfundim asnjë botues nuk ka bërë padi që të mos u paraqiten këto indekse të miliarda librave. Yahoo, pohon që nuk ka ndërmend që ta bëjë këtë gjë pa autorizimin dhe lejen e autorit apo shtëpive botuese.

Lidhja e Shkrimtarëve e cila përfaqëson rreth tetë mijë shkrimtarë ka marrë vendimin që t'i bëjë padi Google-s për shkak të cënimit të së drejtës së autorit. Por Google, pohon që këtyre librave iu është paraqitur vetëm një pjesë nga përmbledhja e librave.



Në vitin 2020 Nasa do të krijojë një bazë në Hënë

Nasa ka vendosur që në vitin 2020 të krijojë një bazë të përkohshme për astronautët. Është projektuar që kjo bazë të fillojë punën e plotë në vitin 2024 me qëllim që astronautët të kenë mundësi të qëndrojnë afro 180 ditë.

Astronautët që do të shkojnë në Egjipt më vonë do ta përdorin këtë si stacion të tyrin. Që nga viti 1972 njeriu i parë do të shkonte në Hënë me këtë projekt.